



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 450 Akti

Nr. 402 Vendimi

Tiranë, më 17.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 15.6.2021, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Agim Dalipaj**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Agim Dalipaj, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Agim Dalipaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Alma Faskaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Agim Dalipaj.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Agim Dalipaj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Prokuroria e Përgjithshme. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Agim Dalipaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontaktet të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit raportin² e vlerësimit të figurës, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 2.11.2017.

12. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 27.5.2021 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Agim Dalipaj, si dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

15. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni me anë të postës elektronike të datës 28.5.2021.

15.1. Në datën 29.5.2021 subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike, kërkoi shtyrjen e afatit për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit, për shkak të ngarkesës në punë, si dhe për shkak të faktit se provat ndodhen në një qytet tjetër nga ai që ushtron detyrën subjekti.

15.2. Komisioni, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, vendosi ta pranojë atë, duke shtyrë afatin për paraqitjen e provave dhe shpjegimeve deri në datën 11.6.2021.

15.3. Subjekti i rivlerësimit, në datën 11.6.2021, dërgoi nëpërmjet postës elektronike parashtrime në lidhje me rezultatet e hetimit, si dhe paraqiti prova dhe dokumentacion mbështetës.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2018

² Deklasifikuar me vendimin nr. *** , datë 26.5.2021, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2019

16. Pas administrimit të parashtrimeve të subjektit, provave dhe dokumentacionit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike, me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail* në datën 11.6.2021.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 15.6.2021, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Agim Dalipaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Agim Dalipaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Ai u është përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

21. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime, kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

23. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. *, datë 11.6.2021.

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i papabuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.’”

analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; si dhe (g) shpjegimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

25. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

26. Apartament banimi⁶, me sip. 89 m², marrë nga Enti Kombëtar i Banesave, me kontratë nr. *, datë 25.7.2012, ndodhur në lagjen “Besëlidhja” p. ***, ap. *, Lezhë, e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 27.4.2009, në emër të EKB-së. Vlera: 3.355.171 lekë, likuiduar deri tani bashkë me interesin 840.083 lekë. Pjesa takuese: 100 %.**

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: nuk deklarohet burim.

Konstatimi i ILDKPKI-së

❖ *Është i paqartë fakti që subjekti ka qenë në procese gjyqësore për përfitimin e këtij apartamenti nga EKB-ja prej vitit 2006 deri në vitin 2012 kur është lidhur edhe kontrata e shitblerjes.*

Hetimi⁷ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

26.1. Subjekti ka lidhur në datën 25.7.2012 kontratën tip “kontratë shitjeje”, me këste, me nr. ***, me palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave Lezhë, të apartamentit *+*, me sip. 89,8 m², nr. pasurie ***+*-*, z. k. ***, regjistruar në ZVRPP-në Lezhë, në vlerën 3.355.171 lekë, me pagesë për 300 muaj (me këst 13.746 lekë/muaj). Bazuar në vërtetimin për pagesat e kësteve lëshuar nga Enti Kombëtar i Banesave Lezhë rezulton se subjekti ka kryer një pagesë fillestare prej 112.083 lekësh dhe kredia e mbetur për t’u paguar është në shumën 3.243.088 lekë. Deri në datën 24.10.2016 është paguar shuma 737.304 lekë, duke mbetur si detyrim shuma 2.795.277 lekë.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratën tip “kontratë shitjeje” me këste, nr. ***, datë 25.7.2012; (ii) vërtetim nga dokumenti hipotekor, nr. ***, datë 27.4.2009; (iii) vërtetim për pagesat e kryera lëshuar nga Enti Kombëtar i Banesave Lezhë.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020, drejtuar UK-së Lezhë; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.1.2020, e UK-së Lezhë; shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020, drejtuar OSHEE-së; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.1.2020, e OSHEE-së; shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.7.2020, e ASHK-së Lezhë; shkresë nr. *** prot., datë 10.3.2021, drejtuar noterit publik V. M; shkresë kthim përgjigje nr. ** prot., datë 18.3.2021, e noterit publik V.M; shkresë nr. *** prot., datë 29.4.2021, drejtuar EKB-së; shkresat kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.5.2021, dhe nr. *** prot., datë 4.5.2021, të EKB-së.

26.1.1. Sipas deklarimeve të subjektit në procesverbalin e datës 12.2.2016⁸, me vendimin nr. **, datë 23.12.2005, të Këshillit Bashkiak Lezhë, ka fituar të drejtën si i pastrehë për të marrë apartament. Për të lidhur një parakontratë me EKB-në subjekti ka parapaguar shumën 120.000 lekë dhe pas lidhje së parakontratës ka hyrë në banesë.

26.1.2. Në datën 22.12.2010, me deklaratën noteriale⁹ nr. *** subjekti ka deklaruar se *është i pastrehë dhe sipas ligjit atij i takon një banesë dhe sipas vendimit të Këshillit Bashkiak Lezhë i është caktuar banesa nr. *, në pallatin nr. ***, në lagjen “B” të qytetit të Lezhës. Në këtë banesë ai ka hyrë në fund të vitit 2005 dhe ka meremetuar apartamentin, i cili nuk ka qenë në kondicione teknike. Apartamenti ka qenë i dëmtuar rëndë, pasi ishin dëmtuar dyert, dritaret dhe kishte rënë suvaja.*

Subjekti i rivlerësimit është pyetur në lidhje me këtë deklaram, i cili, në përgjigje të pyetësorit të datës 4.5.2021, ka deklaruar se ka komunikuar me firmën ndërtuese për riparimin e disa defekteve të dritareve dhe dyerve të brendshme, si dhe rënie të pjesshme të suvatimit, e cila ka kryer riparimet pa pagesë.

Deklarimi i subjektit se punimet janë kryer nga firma ndërtuese pa pagesë nuk përputhet me deklaramin e tij në deklaratën noteriale të vitit 2010, në të cilën ka deklaruar se i ka kryer vetë punimet. Gjatë hetimit nuk u vu në dispozicion nga subjekti asnjë dokumentacion provues nga EKB-ja dhe firma ndërtuese (për të cilën nuk ka dhënë asnjë informacion se cila është) për të provuar faktin se punimet shtesë në banesë janë bërë pa pagesë nga firma ndërtuese. Për sa kohë ky apartament rezulton të jetë ndërtuar nga EKB-ja dhe është në pronësi të saj, nuk kishte se si firma ndërtuese të kryente punime pa pagesë në favor të subjektit, pasi nuk kishte asnjë detyrim ligjor ndaj tij.

26.1.3. Në përfundim të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës: (i) për mosdeklarim të shpenzimeve të kryera prej tij për punime shtesë në apartamentin në Lezhë; (ii) subjekti nuk ka provuar me dokumentacion që punimet shtesë janë kryer pa pagesë nga firma ndërtuese, për të cilën nuk ka dhënë asnjë informacion se cila është.

26.1.4. Në parashtrimet e paraqitura, subjekti ka pretenduar se apartamenti është ndërtuar me kontratë sipërmarrjeje ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të EKB-së, në cilësinë e investitorit, dhe shoqërisë ndërtuese “Gj” sh.p.k. Në bazë të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” shoqëria ndërtuese e ka si detyrim sipas kontratës së lidhur me EKB-në, në nenin 47 të saj, të bëjë riparimet 12 muaj pas aktit të kolaudimit dhe aktit të dorëzimit.

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin e mëposhtëm:

- leje ndërtimi, datë 20.12.2002, lëshuar shoqërisë “Gj sh.p.k., me objekt “lokal shërbimi + banesë, gjithsej 6 kate”;
- leje shfrytëzimi, datë 27.12.2007, për objektin lokal shërbimi + banesë, gjithsej 6 kate;
- akt-kolaudimi, datë 26.4.2005, për banesë tip *** me 10 apartamente;
- kontratë sipërmarrjeje, datë 9.7.2002, lidhur midis shoqërisë “Gj” sh.p.k. dhe Drejtorisë së Përgjithshme të EKB-së – në nenin 47 të kësaj kontrate përcaktohet se sipërmarrësi, pas aktit të kolaudimit dhe dorëzimit të objektit, është i detyruar, me shpenzimet e veta, të bëjë riparimet e punimeve për suvatimin e brendshëm dhe të jashtëm të banesës;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.6.2021, e shoqërisë “Gj” sh.p.k., sipas së cilës riparimet janë bërë pa pagesë nga kjo shoqëri në periudhën shkurt - mars të vitit 2006 tek disa nga banesat e pallatit.

26.1.5. Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse në lidhje me këtë rezultat të hetimit.

⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.3.2021, të ILDKPKI-së.

⁹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ** prot., datë 18.3.2021.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të dhëna jo të sakta në deklaratën noteriale të vitit 2010, fakt i pranuar edhe nga vetë subjekti. Ky fakt do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

26.2. Në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti, subjekti, në procesverbalin e datës 12.2.2016¹⁰, në ILDKPKI, ka deklaruar shumën 300.000 lekë, ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit të datës 11.3.2021, deklaroi se vlera e mobilimit ka qenë 500.000 lekë. Komisioni i ka kërkuar subjektit të saktësojë kohën e mobilimit dhe vlerën e tij, i cili në përgjigje të pyetësorit të datës 4.5.2021 ka deklaruar se: *“Në muajin mars të vitit 2006 kam filluar të banoj në këtë banesë duke e mobiluar me shumën e lartpërmendur¹¹”*.

Bazuar në deklaratimet e subjektit, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare si vlerë mobilimi shumën 500.000 lekë dhe kohën e kryerjes së tij deri në mars të vitit 2006.

Komisioni ka kryer analizën financiare në lidhje me shpenzimet për mobilimin e këtij apartamenti.

Tabela nr. 1

	Mars 2006
TË ARDHURA, dokumentuar	200,115.00
Të ardhura nga paga e subjektit, të tërhequra	90,000.00
Të ardhura nga paga e bashkëshortes së subjektit	107,830.50
Të ardhura nga interesat e depozitave	2,284.50
SHPENZIME	609,557.00
Shpenzime jetese	109,557.00
Investime/mobilim për apartamentin, pyetësori standard	500,000.00
Mundësia për kursime	-409,442.00

Bazuar në nxjerrjet e llogarive bankare të subjektit dhe personave të lidhur, në analizën financiare janë konsideruar të ardhura fondet e tërhequra nga llogaria e pagës deri në datën 23.3.2006.

26.2.1. Bazuar në këtë analizë, subjektit iu kalua barra e provës për pamundësi financiare në shumën 409.442 lekë për mobilimin e apartamentit.

26.2.2. Në kundërshtim të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se vlera e mobilimit është 300.000 lekë dhe jo 500.000 lekë, pasi me vlerën 500.000 lekë ka nënkuptuar shpenzimet e kryera deri në vitin 2020. Analiza duhet të bëhet për 6-mujorin e parë të vitit 2006, pasi kjo është periudha për të cilën ka bërë përgatitjet për të hyrë në banesë. Subjekti ka deklaruar se në analizë nuk është përfshirë mundësia për kursim e vitit 2005, si dhe të ardhurat nga vizitat për blerjen e banesës së re nga të afërmit dhe kolegët.

26.2.3. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Komisioni, jo pa qëllim, në datën 4.5.2021, ka pyetur subjektin në lidhje me mobilimin, i cili ka deklaruar qartësisht se është bërë në vlerën e lartpërmendur, pra 500.000 lekë dhe në muajin mars kur ka filluar të banojë. Në lidhje me pretendimin për të ardhurat nga viti 2005, Komisioni vlerëson se për sa kohë nuk janë deklaruar si kursime *cash* në DPV/2005, ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare. Gjithashtu, për sa kohë subjekti nuk rezulton që të ketë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, por edhe në deklaratën “Vetting” të ardhura të përfituara nga vizitat për blerjen e banesës së re, nga ana e tij nuk rezulton të jetë saktësuar vlera e përfituar dhe këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare.

¹⁰ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.3.2021, të ILDKPKI-së.

¹¹ I referohet shumës 500.000 lekë.

26.2.4. Në përfundim rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit të apartamentit në shumën 409.442 lekë, e cila në vlerësim të Komisionit, duke u bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

26.3. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se ka jetuar në godinën e Prokurorisë Lezhë për periudhën nëntor 1998 – korrik 2006. Për të provuar këtë deklaramin subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 24.1.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, sipas të cilit ai ka jetuar në katin e tretë të kësaj godine për periudhën nëntor 1998 – korrik 2006. Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se nga marsi i vitit 2006 ka jetuar në apartamentin e përfituar nga EKB-ja.

26.3.1. Komisioni ka konstatuar mospërputhje midis deklaramive të subjektit gjatë hetimit administrativ dhe vërtetimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në lidhje me periudhën e jetesës në godinën e kësaj prokurorie. Për këtë subjektit iu kalua barra e provës.

26.3.2. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vërtetimi i lëshuar nga prokuroria është i saktë. Ai ka jetuar në godinën e Prokurorisë së Rrethit Lezhë për periudhën nëntor 1998 – korrik 2006. Deklarimi i tij se nga marsi i vitit 2006 ka jetuar në apartamentin e përfituar nga EKB-ja është bërë pasi ka pasur në konsideratë momentin kur ka marrë në administrim apartamentin. Periudha mars – korrik 2006 ka shërbyer për riparimin e sipërpërshkruar dhe përgatitjen e apartamentit për të sjellë familjen.

26.3.3. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 4.5.2021, ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament në mars të vitit 2006. Deklarimi i tij se periudha mars – korrik 2006 ka shërbyer për riparimin e apartamentit nuk përputhet me deklaratën noteriale të shoqërisë “Gj” sh.p.k. të dorëzuar nga vetë subjekti, në të cilën kjo shoqëri deklaron se punimet janë bërë në periudhën shkurt - mars dhe janë dorëzuar te banorët.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka paraqitur së bashku me deklaratën “Vetting” një dokument që nuk përmban të dhëna të sakta, pasi bazuar në deklaramet e tij ai ka jetuar në këtë apartament që nga marsi i vitit 2006 dhe jo nga korriku i vitit 2006. Ky fakt do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

26.4. Bazuar në vendimin nr. ***, datë 10.4.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë rezulton se subjekti ka qenë palë e tretë në gjykimin me paditës Prefektura e Qarkut Lezhë dhe të paditur Këshilli i Bashkisë Lezhë, me objekt “deklaramin e pavlefshmërisë pjesërisht të vendimit nr. **, datë 23.12.2005, të Këshillit Bashkiak Lezhë për ndarjen e banesave për të pastrehët”.

Sipas këtij vendimi Prefektura e Qarkut Lezhë ka paraqitur padinë me objektin e mësipërm, duke pretenduar se subjekti me tre shtetas të tjerë nuk kanë statusin e të pastrehëve.

Kjo padi është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila ka argumentuar se subjekti së bashku me shtetasit e tjerë e kanë fituar statusin e të pastrehut konform ligjit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 1.9.2006. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. **, datë 4.1.2008, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prefektura e Qarkut Lezhë.

26.5 Bazuar në shkresën e ASHK-së Lezhë¹² rezulton se subjekti është bashkëpronar me 1/30 pjesë takuese në pasurinë nr. **+*.*, z. k. ***, me sip. 84,54 m², në qytetin e Lezhës. Kjo pasuri (përfituar nga babai i subjektit nëpërmjet privatizimit) rrjedh nga dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshuar me vendimin nr. ***, datë 5.2.2011, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për të ndjerin R. D.

¹² Shkresë nr. **** prot., datë 8.7.2020

Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën “Vetting” pronësinë e tij mbi këtë apartament.

Në përgjigje të pyetësorit të datës 4.5.2021, subjekti, në lidhje me këtë apartament, ka sqaruar se *banesa është e prindërve të tij [...]. Në nëntor të vitit 1998 është larguar nga banesa, ku ka qenë nëna, vëllai i dytë L dhe vëllai tjetër S (kur vinte me pushime). Në datën 26.12.2011 vëllai i tij L, që jetonte në këtë banesë bashkë me nënën, ka bërë rivlerësimin e saj sipas ligjit të kohës dhe banesa që deri në atë kohë ka qenë në emër të babait ka kaluar në emër të nënës, vëllait L, vëllait S dhe më poshtë emrat e motrave dhe emri i tij [...]. Për rivlerësimin e bërë nga vëllai i tij, L në vitin 2011 nuk ka pasur dijeni se janë shënuar emri i tij dhe i dy motrave [...]. Kjo banesë, sipas amanetit të prindërve të tij, i është lënë vëllait të vogël S. Nga dhjetori i vitit 2019, kohë kjo që është ndarë nga jeta nëna e tij, vëllai dhe dy motrat nuk kanë mundur të vijnë në Lezhë për arsye pandemie për të kryer veprimin e kalimit të kësaj banese në pronësi të vëllait, S.*

Deklarimi i subjektit se nuk kishte dijeni në lidhje me pronësinë e tij mbi këtë banesë nuk është bindës, pasi duke qenë jurist ka pasur njohuritë e nevojshme ligjore për të kuptuar se ka trashëguar nga babai pjesë takuese nga ky apartament, sipas vendimit nr. ***, datë 5.2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

26.6. Nga hetimi është konstatuar se nëna e subjektit ka pasur një depozitë në shumën 3.505.376 lekë në “Raiffeisen Bank”, në datën 1.10.2011. Bashkëshortja e subjektit ka tërhequr nga kjo depozitë shumat e mëposhtme:

- në datën 28.1.2013, shuma 300.000 lekë;
- në datën 11.3.2013, shuma 200.000 lekë;
- në datën 5.4.2013, shuma 300.000 lekë;
- në datën 20.5.2013, shuma 341.000 lekë;
- në datën 3.5.2013, shuma 300.000 lekë.

Në total shuma 1.441.000 lekë

26.6.1. Në lidhje me këto tërheqje subjekti sqaron se janë bërë me autorizimin e nënës për të rikonstruktuar banesën e saj. Kjo banesë ka rezultuar se në fakt është në bashkëpronësi të subjektit, nënës, vëllezërve dhe motrave të tij. Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti rezulton se për rikonstruksionin e banesës është shpenzuar në total shuma 1.666.509 lekë.

26.6.2. Për sa më sipër, rezulton se për banesën që subjekti ka në bashkëpronësi me familjarët e tij (që nuk është deklaruar prej tij në deklaratën “Vetting”, por edhe gjatë hetimit) janë kryer punime nga bashkëshortja për llogari të nënës së tij.

26.6.3. Subjektit iu kalua barra e provës, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se ka në bashkëpronësi apartament me sip. 84,54 m².

26.6.4. Në parashtrimet e paraqitura, subjekti ka sqaruar se *këtë apartament nuk e ka deklaruar me qëllim për ta fshehur, pasi fitimi i pronësisë është i ligjshëm në bazë të trashëgimisë ligjore [...]. Arsyeja e mosdeklarimit ka qenë se ai nuk ka jetuar në të vitet e fundit, në këtë apartament ka jetuar nëna dhe vëllai i dytë L.D dhe veprimet janë bërë nga ana e tij në vitin 2011 pa e njoftuar [...]. Është e vërtetë se janë kryer punime në banesë, por këto punime nuk janë kryer nga bashkëshortja, pasi ajo ka administruar paratë e nënës së tij...*

26.6.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse, për sa i përket faktit të mosdeklarimit të këtij apartamenti në deklaratën “Vetting”. Komisioni, duke marrë në konsideratë pjesën takuese të subjektit prej 1/30 (2,5 m²) në këtë apartament dhe origjinën e tij që vjen nga trashëgimia, vlerëson se mosdeklarimi i apartamentit nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit.

26.7. Në përfundim të analizës për pasurinë apartament me sip. 89 m², ndodhur në Lezhë, Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij, por nuk ka pasur të ardhura

të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit, si dhe ka qenë kontradiktor në lidhje me kohën e fillimit të jetesës në këtë apartament, konstatime të cilat do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

27. Apartament banimi ¹³, me sip. 53 m², në qytetin e Shëngjinit, ndërtuar në vitin 2006, marrë nga shoqëria “B. I” sh.p.k., me vlerë 21.500 euro, me marrëveshje është rënë dakord për vlerën 2.200.000 lekë, nga të cilat 1.600.000 lekë janë likuiduar dhe diferenca do të likuidohet pas hipotekimit të apartamentit. E paregjistruar në regjistrat hipotekorë. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat nga puna deri në vitin 2002 dhe dhënë gjatë kësaj periudhe ndër vite.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- ❖ *Fshehje e banesës me sip. 53 m² në deklaratat e interesave private periodike vjetore të viteve 2006 - 2008, në vlerën 21.500 euro.*
- ❖ *Deklarim i rremë dhe mungesë e burimeve të ligjshme financiare për pagesën e banesës me sip. 53 m² në Shëngjin, në vlerën 21.500 euro.*
- ❖ *Është e paqartë përfshirja e bashkëshortes së subjektit në procedurat e legalizimit në datën 4.4.2017 (apo 2014) për ndërtimin e ngritur në vitin 2006 në adresën Shëngjin, Bashkia Lezhë. Gjithashtu, edhe kërkesa për legalizim nga znj. F. D për ndërtimin e ngritur në vitin 2002, në adresën Shëngjin, Bashkia Lezhë.*

Hetimi¹⁴ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

27.1. Bashkëshortja e subjektit, me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 8.8.2006, ka porositur nga shoqëria “B. I” sh.p.k. apartament banimi me sip. 53 m², me çmim 400 euro/m², në vlerën 21.500 euro. Në nenin 4 të kontratës përcaktohet se porositësja e likuidon shoqërinë jashtë zyrës së noterisë.

Bashkëshortja e subjektit, në datën 4.4.2014, në lidhje me këtë apartament ka kërkuar të bëhet pjesë e procesit të legalizimit në një ndërtim pa leje (objekti ku ishte ndërtuar ky apartament). Aplikimi i mësipërm nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”.

Bazuar në kërkesën nr. *** prot., datë 4.4.2017, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se kërkon legalizimin e objektit të saj të ndërtuar në vitin 2002. Kjo kërkesë për legalizim është miratuar¹⁵ dhe pasuria rezulton e regjistruar në ASHK-në Lezhë me nr. pasurie ***/ND+*-*, z. k. ***, në emër të bashkëshortes dhe subjektit.

27.2. Në lidhje me pagesën e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se ka paguar shumën 1.600.000 lekë dhe diferenca do të paguhet kur të hipotekohet apartamenti. Për të provuar deklarinimin e tij subjekti ka depozituar deklaratën e datës 24.11.2011 (e panoterizuar), nga shtetasi L. Rr, i cili ka deklaruar se *në bazë të kontratës nr. ***, datë 8.8.2006, ka shitur apartament banimi me sip. 65 m², në shumën 21.500 euro (në vlerën 2.200.000 lekë), nga e cila i janë dhënë vetëm shuma 1.600.000 lekë dhe pjesa tjetër prej 600.000 lekësh nuk është paguar, pasi nuk është kryer hipotekimi i pallatit.*

27.3. Subjekti e ka deklaruar këtë apartament për herë të parë në DPV/2009, si vijon: “*Banesë *+* (65 m²), Shëngjin, blerë te firma ‘B’ sh.p.k. nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes*”. Tek vlera ka shënuar shumën 21.000 euro.

¹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 8.8.2006; si dhe (ii) deklaratën datë 24.11.2011 (e panoterizuar), nga shtetasi L. Rr.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 10.3.2021, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 2.4.2021, e ASHK-së; shkresë nr. *** prot., datë 29.4.2021, drejtuar Drejtorisë Vendore, ASHK-ja Lezhë; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.4.2021, e ASHK-së Lezhë.

¹⁵ Lëshuar leje legalizimi nr. ***, datë 11.9.2017

Në këtë DPV nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar se i ka likuiduar shoqërisë së ndërtimit shumën 1.600.000 lekë dhe se i ka detyrim shumën 600.000 lekë, por ka deklaruar vlerën e plotë të çmimit të blerjes.

27.4. Në lidhje me burimin e blerjes së këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se janë të ardhurat nga puna deri në vitin 2002 dhe dhënë gjatë kësaj periudhe ndër vite.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike rezulton se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* ndër vite, si dhe nuk rezulton të ketë deklaruar ndonjë pagesë në favor të shoqërisë “B. I” sh.p.k. Gjithashtu, subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në periudhën 2006 – 2009.

Në lidhje me këto konstatime, subjekti ka sqaruar¹⁶ se *arsyeja e mosdeklarimit ka qenë se pallati në të cilin ka përfutuar pronën ka filluar ndërtimin në vitin 2002 nga firma “B” sh.p.k. dhe në pamundësi për ta përfunduar brenda afateve firma ndërpreu punimet për arsye financiare. Objekti ishte në hapat e para të ndërtimit dhe në vitin 2006 kur u hodhën kolonat e pallatit për lartësitë lidhën kontratën e porosisë [...]. Pallati përfundoi punimet në vitin 2009 (nga një firmë tjetër) dhe ai mori çelësat e banesës, pas kësaj u realizua kontrata e porosisë. Ai u bë me pronë pa dokumente dhe e deklaroi në vitin 2009. Për deklarimet e dorëzuara në vitin 2010 për vitin 2009 është thirrur për sqarim në ILDKPKI (në datën 12.10.2010), ku ka deklaruar me dokument të lëshuar nga pronari L.Rr se për shumën sipas kontratës së porosisë të shumës 21.000 euro (2.200.000 lekë) bashkëshortja i ka dhënë shumën 1.600.000 lekë dhe i detyrohet shumën 600.000 lekë. Ai nuk e ka deklaruar në DPV-të e viteve pasardhëse, pasi e ka quajtur të deklaruar [...]. Deri në vitin 2003 ai dhe bashkëshortja i kanë marrë pagat *cash* dhe jo me bankë, para këto të mbajtura në banesë. Nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes në këto vite është ruajtur kjo shumë parash dhe i është dhënë në mënyrë të pjesshme sa herë iu është dashur për të kryer veprime të ndryshme financiare çiftit Rr, në formë huaje, pasi kishin lidhje shoqërore me ta. Kjo shumë iu është dhënë pa veprime para noterit apo deklaratë dore, por në mirëbesim. Pra, arsyeja e mosdeklarimit është se në vitet kur filloi deklarimi nuk e kishte *cash* në banesë këtë shumë, por ia kishte dhënë hua dhe nuk kishte asnjë dokument për këtë borxh të dhënë...*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, ka konstatuar se:

i. Deklarimi i subjektit se si burim për blerjen e këtij apartamenti ka shërbyer kthimi i një huaje dhënë ndër vite z. L. Rr, nuk përputhet me deklaratimet e tij në ILDKPKI.

Subjekti, bazuar në procesverbalin e datave 12.10.2010 dhe 23.11.2011¹⁷ në ILDKPKI në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, ka deklaruar se janë të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes që vijnë si rezultat i pagave dhe ai është mjaftuar vetëm me deklarimin e të ardhurave.

Siç rezulton nga deklaratimet e subjektit në ILDKPKI, asnjëherë nuk ka deklaruar faktin se shuma e paguar shoqërisë “B.I” sh.p.k. ishte në fakt një hua dhënë z. L.Rr.

Subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për të provuar dhënien e shumave hua, por edhe konvertimin e tyre në vlerë apartamenti.

ii. Subjekti e ka porositur këtë apartament në vitin 2002.

iii. Deklarimi i tij se në vitin 2009 u realizua kontrata e porosisë nuk përputhet me dokumentacionin e administruar, pasi kontrata është lidhur në vitin 2006.

27.4.1. Në lidhje me mosdeklarimin e kursimeve *cash* dhe huan e pretenduar të dhënë z. L. Rr:

i. Komisioni konstaton se subjekti ka pasur dijeni në lidhje me mënyrën e deklarimit të kursimeve *cash*, pasi nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore rezulton se ai ka deklaruar si burim për llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank” kursimet *cash*. Subjekti ka deklaruar kursimet e tij për periudhën 2003 – 2009, të paraqitura në tabelën si vijon:

¹⁶ Shihni pyetësorin datë 21.1.2021

¹⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.3.2021, të ILDKPKI-së.

Tabela nr. 2

Viti	Deklarimi i subjektit
2003	Zëri likuiditete: depozitë Banka e Kursimeve 600,000 lekë, burimi: kursime
2004	Zëri pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme: depozitë në “Raiffeisen Bank” 700,000 lekë
2005	Zëri pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme: para nga paga në “Raiffeisen Bank” 500,000 lekë
2008	Zëri ndryshimi i interesave private: nga kursimet nga paga të kursyera në llogarinë në “Raiffeisen Bank”, shuma 800,000 lekë
2009	Zëri të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private: kursyer 800,000 lekë, “Raiffeisen Bank”

ii. Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në deklarin e tij fillestar të vitit 2003, por as në vijim, se i kishte dhënë hua z. L.Rr. Ai nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën “Vetting” se si burim për blerjen e këtij apartamenti ka shërbyer një hua e dhënë z. L. Rr në vitin 2002. Gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se pagesa e këtij apartamenti ka qenë konvertimi i huas dhënë z. L. Rr.

Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në DVP/2009 nuk rezulton që të ketë deklaruar që pagesa për këtë apartament ka qenë në fakt hua dhënë z. L. Rr.

Në kontratën e porosisë, por edhe në deklaratën e z. L.Rr, nuk deklarohet fakti se pagesa e kryer ka qenë një hua dhënë këtij të fundit, e cila është konvertuar në vlerë apartamenti. Z. L.Rr, në deklaratën e datës 24.11.2011, ka deklaruar se ka bërë shitjen e një apartamenti në vitin 2006 dhe subjekti i ka dhënë shumën 1.600.000 lekë, por nuk ka deklaruar se kjo shumë në fakt ishte një hua e konvertuar në vlerë apartamenti.

Subjekti, gjatë hetimit administrativ, nuk cilësoi se sa ka qenë shuma e huas dhënë z. L. Rr dhe periudhën e saktë se kur është dhënë kjo hua.

Për sa më sipër, analiza financiare për këtë apartament do të kryhet duke konsideruar vetëm të ardhurat e vitit 2006 dhe kohën e kryerjes së pagesës, vitin 2006, pasi subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* deri në këtë vit, si dhe depozitat e likuiditetet në banka nuk janë pakësuar.

27.4.2. Në lidhje me detyrimin e shumës 600.000 lekë, Komisioni vlerëson se subjekti nuk rezulton ta ketë deklaruar këtë detyrim për vitet 2006 - 2009. Subjekti nuk rezulton që në DVP/2009 e në vijim të ketë deklaruar detyrimin në shumën 600.000 lekë ndaj shoqërisë “B. I” sh.p.k. Gjithashtu, në lidhje me shumën 600.000 lekë, subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues nga shoqëria “B. I” sh.p.k., por një deklaratë të thjeshtë të z. L.Rr.

Për sa më sipër, në analizën financiare, duke marrë në konsideratë deklarinimet e subjektit në DVP/2009, por dhe faktin që apartamenti është legalizuar dhe ka kaluar në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes, do të konsiderohet si e paguar e gjithë shuma në vlerën 21.000 euro.

27.4.3. Analiza financiare – tabela nr. 3

	Datë 8.8.2006
PASURI	2,519,892.99
Apartament me sip. 65 m ² nga “B” sh.p.k.	2,200,000.00
Shtesa/pakësime, likuiditete	319,892.99
DETYRIME	0.00
Detyrim i mbetur për apartamentin me sip. 65 m ²	0.00
PASURI NETO = PASURI - DETYRIME	2,519,892.99
TË ARDHURA, dokumentuar	946,710.67
Të ardhura nga paga e subjektit	634,698.00
Të ardhura nga paga e bashkëshortes së subjektit	287,548.00

Të ardhura nga interesat e depozitave	24,464.67
SHPENZIME	755,633.00
Shpenzime jetese	255,633.00
Investime/mobilim për ap., pyetëtori standard	500,000.00
Mundësia për kursime	-2,328,815.32

Në përfundim të analizës financiare rezulton se subjekti ka qenë në pamjaftueshmëri mjetesh financiare në shumën -2.328.815,32 lekë.

27.5. Komisioni ka hetuar në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi me shitësin/huamarrësin e apartamentit.

27.5.1. Komisioni, në datën 10.3.2021, me shkresën nr. *** prot., i ka kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë informacion të detajuar nëse subjekti i rivlerësimit kishte hetuar, ndër të tjera, edhe shtetasin L. Rr. Prokuroria, në datën 16.3.2021, me shkresën nr. *** prot., ka kthyer përgjigje duke informuar se për periudhën 2011 – 2021 subjekti nuk e kishte hetuar shtetasin L.Rr.

27.5.2. Duke qenë se përgjigja nuk ishte e plotë, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 29.4.2021, i ka kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në datën 12.5.2021, me shkresën nr. ***.* prot., kjo prokurori informon se subjekti ka hetuar çështjen nr. ***, me të pandehur z. L.Rr dhe ka vendosur pushimin e saj në datën 21.2.2003.

27.5.3. Në nenin 26 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *“1. Prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17”*.

Në nenin 17/1 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

“a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit ose i fëmijëve të tij;

b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij;

c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit;

ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërin prej palëve private;

d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale;

dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim;

e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16;

ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”.

27.5.4. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 21.1.2021, ka deklaruar se:

i. Me z. Rr dhe bashkëshorten e tij kishin lidhje shoqërore.

ii. Në vitin 2002 kishte porositur apartamentin në objektin që kishte filluar të ndërtohej.

iii. I ka dhënë hua z. Rr në disa raste deri në vitin 2003.

Për sa më sipër, subjekti, bazuar në nenet 17/1 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në momentin që ka hetuar procedimin në ngarkim të z. L. Rr, pasi ka pasur marrëdhënie shoqërore me të, si dhe pretendon se i ka dhënë hua këtij shtetasi.

27.5.5. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 11.3.2021, i pyetur nga Komisioni në lidhje me faktin nëse ka hetuar procedime në ngarkim të shtetasit L. Rr, ka refuzuar të deklarojë një fakt të tillë, duke anashkaluar emrin e këtij shtetasi dhe duke deklaruar se nuk ka hetuar procedime në ngarkim të shoqërisë “B.I” sh.p.k. dhe Entit Kombëtar të Banesave.

27.6. Në përfundim të hetimit në lidhje me këtë apartament, ka rezultuar se subjekti: (i) nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e tij në shumën -2.328.815,32 lekë; (ii)

nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” faktin se bashkëshortja e tij ka aplikuar për legalizimin e apartamentit në vitin 2014; (iii) nuk rezulton të ketë deklaruar kontratën e porosisë për këtë apartament për vitet 2006 - 2009; (iv) nuk rezulton të ketë deklaruar në deklarinimin e tij fillestar të vitit 2003, por as në vijim se i kishte dhënë hua z. L. Rr; (v) nuk ka deklaruar sa ka qenë shuma totale e dhënë hua z. L. Rr, si dhe periudhën kur është dhënë kjo hua; (vi) nuk ka provuar me dokumentacion: (a) dhënien e huas z. L.Rr; (b) kthimin e huas dhënë z. L.Rr që është konvertuar në apartament; (c) pagimin e shumës 1.600.000 lekë shoqërisë “B.I sh.p.k. dhe detyrimin e shumës 600.000 lekë; (vii) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe në deklarinimet periodike vjetore se si burim për blerjen e këtij apartamenti ka shërbyer konvertimi i huas dhënë z. L.Rr; (viii) nuk rezulton të ketë deklaruar për periudhën 2006 deri në deklaratën “Vetting” se i detyrohet shoqërisë “B. I” sh.p.k. shumën 600.000 lekë; (ix) ka fshehur gjatë hetimit administrativ faktin që ka hetuar procedim penal në ngarkim të z. L.Rr; (x) bazuar në nenet 17/1 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale duket se ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në momentin që ka hetuar/pushuar procedimin në ngarkim të z. L.Rr, pasi ka pasur marrëdhënie shoqërore me të, kishte porositur një apartament në një objekt që po ndërtohej prej z. Rr si dhe pretendon se i ka dhënë hua këtij shtetasi.

27.6.1. Si rrjedhojë e rezultateve të mësipërme ngrihen dyshime të arsyeshme se subjekti nuk e ka blerë këtë pasuri (pasi siç rezulton nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e saj), por e ka përfituar nga z. L.Rr në kushtet e konfliktit të interesit.

Për të gjitha këto rezultate të hetimit subjektit iu kalua barra e provës.

27.7. Për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, subjekti shpjegoi se *shuma reale e paguar është 1.600.000 lekë. Pjesa tjetër do t'i jepej kur të hartohej akti i pronësisë. Në kushtet kur nuk ishte bërë akti i pronësisë nga ndërtuesi, atij nuk i është dhënë kjo shumë. Dokumentet e pronësisë janë bërë me procedurë legalizimi, shpenzimet për këtë procedurë janë bërë nga ana e tyre, ndaj kjo është shuma reale që ai ka paguar. Pasurinë e ka deklaruar në vitin 2009, pasi në këtë moment ka formalizuar marrëveshjen ku janë sheshuar edhe detyrimet e ndërsjella që kanë pasur me njëri-tjetrin, detyrime këto të paformalizuara [...]. Burimi i kësaj pasurie janë të ardhurat nga puna dhe kursimet cash gjatë viteve 1984 - 2002. Pagesa është bërë në vite dhe ndërtuesi ka pasur ndaj tij detyrime financiare të akumuluar, sipas shpjegimeve që ka dhënë kur është thirrur nga inspektorët e ILDKPKI-së në vitin 2010 dhe e ka menduar të sqaruar dhe të deklaruar saktë [...]. Fakti se apartamenti është porositur në vitin 2006 nuk do të thotë se janë bërë pagesa, pasi ndërmjet tij dhe ndërtuesit ka ekzistuar një marrëdhënie reale detyrimi huaje, e cila ka qenë informale [...]. Po ashtu, fakti se në DVP/2009 e në vijim nuk ka deklaruar detyrimin në shumën 600.000 lekë ndaj shoqërisë “B” sh.p.k. ka ndodhur për shkak se ka vlerësuar se ky detyrim i deklaruar në ILDKPKI në vitin 2010 për DVP/2009 e ka quajtur të deklaruar [...]. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën “Vetting” për aplikimin për legalizim në vitin 2014 nga ana e bashkëshortes së tij, nuk është bërë, pasi nuk ka pasur rubrikë as në deklaratën “Vetting” dhe as në DVP për të deklaruar edhe aplikimet [...]. Lidhur me mosdeklarimin e huas dhënë z. Rr në deklaratën fillestare për vitin 2003, ka menduar se duke mos pasur dokumente para noterit ose deklarata dore, por të dhëna në mirëbesim, në këto kushte nuk kishte si të deklaronte diçka të padokumentuar [...]. Shuma e dhënë hua është e deklaruar në shumën 1.600.000 lekë, si dhe periudhën nga viti 1996 – 2002 [...]. Në lidhje me mosdeklarimin e hetimit të z. L. Rr nga ana e tij, subjekti shpjegon se ai është paraqitur te drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë në mars të vitit 2021 dhe i ka kërkuar një vërtetim për t'ju përgjigjur pyetjes së Komisionit, ku i është përgjigjur se nuk ka nevojë, pasi ia ka dërguar vetë përgjigjen Komisionit dhe ai nuk rezulton të kishte çështje në emër të shoqërisë “B. I” sh.p.k., pra nuk ka fshehur asnjë fakt në lidhje me këtë rast, për shkak se kanë kaluar 19 vite atij nuk i është kujtuar procedimi në ngarkim të z. Rr [...]. Subjekti pranon që është shkelur neni 26 dhe 17/1 i Kodit të Procedurës Penale, por nga ana e tij nuk është hequr dorë, pasi nuk e ka vlerësuar drejt, duke menduar që është kundërvajtje penale. Pavarësisht kësaj subjekti deklaroi se zgjidhja e procedimit është ligjore [...]. Lidhur me lidhjen shoqërore që ka deklaruar me këtë shtetas subjekti sqaron se ka pasur një shoqëri/njohje si me persona*

të tjerë, ndërsa në fakt bashkëshortja e tij dhe bashkëshortja e z. L. Rr kanë njohje për shkak të pozicioneve të punëve që kanë bërë.

Subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale nr. ***, të shtetasit L.Rr.

27.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova. Deklarimi i subjektit se në vitin 2009 u realizua kontrata e porosisë, nuk përputhet me dokumentacionin e administruar, pasi kontrata është lidhur në vitin 2006 dhe sipas deklarimeve të tij apartamenti është porositur në vitin 2002. Subjekti, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të provojë me dokumentacion provues se i detyrohej shoqërisë “B. I” sh.p.k. shumën 600.000 lekë. Ai nuk arriti të provojë me dokumentacion provues së i kishte dhënë hua z. L.Rr dhe se kjo hua i ishte konvertuar në vlerën e një apartamenti. Subjekti ka pasur detyrimin ligjor që në deklaratën “Vetting” të deklaronte saktë pasuritë e tij, detyrim i cili nuk është zbatuar prej tij, pasi është përpjekur ta paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë apartament, duke: (i) mos deklaruar faktin që kjo pasuri ishte në proces legalizimi; (ii) mos deklaruar saktë burimin që kishte shërbyer për blerjen e kësaj pasurie; (iii) mos deklaruar saktë mënyrën e pagesës për këtë pasuri dhe kohën e kryerjes së saj; si dhe (iv) mos deklaruar saktë vitin e krijimit të kësaj pasurie. Në kushtet kur subjektit në vitin 2002 ka hetuar çështjen nr. *** me të pandehur z. L.Rr, ndërkohë që: (i) kishte porositur një apartament te shoqëria në të cilën z. Rr ishte ortak i vetëm; (ii) kishte marrëdhënie shoqërore me këtë shtetas; si dhe (iii) sipas pretendimeve të tij i kishte dhënë hua një shumë të konsiderueshme z. Rr – ai ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, bazuar në nenet 17/1 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 2.328.815,32 lekë për ndërtimin e këtij apartamenti, si dhe nuk ka pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në deklaratën “Vetting” burimet dhe kohën e saktë të kryerjes së pagesave. Pas analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se subjekti: (i) nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament të ndodhur në Shëngjin; (ii) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” në mënyrë të plotë dhe të saktë pasurinë; si dhe (iii) gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjendet në situatën e konfliktit të interesit, në kuptim të germës “d” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

28. Depozitë¹⁸ në shumën 10.000.000 lekë – pjesa takuese: 100 %

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: kursim plus interes për vitet 2003 - 2016.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- ❖ *Është e dyshimtë mënyra e krijimit të depozitës prej 10.000.000 lekësh vit pas viti nga kursimet nga pagat.*
- ❖ *Subjekti nuk ka deklaruar llogarinë e pagës në vlerën 543.495 lekë, në deklaratën “Vetting”.*

Hetimi¹⁹ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

28.1 Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank”, rezulton se:

- i. Subjekti ka llogari bankare me gjendje në datën 30.12.2016, në vlerën 497.727,43 lekë. Megjithëse kjo llogari page e subjektit është e provueshme nga të dhënat që administrohen nga banka, rezulton se ai nuk e ka deklaruar në deklaratën “Vetting”. Për këtë subjektin iu

¹⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 23.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”; si dhe (ii) nxjerrje llogarie datë 23.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.12.2019, e DPSHTRR-së.

kërkuan shpjegime, i cili sqaroi se çdo vit ka depozituar së bashku me deklaratat periodike vjetore nxjerrjet e llogarisë në “Raiffeisen Bank”. Që nga momenti i marrjes së pagës me bankë subjekti nuk ka bërë asnjë veprim tjetër përveç transferimit të shumave nga llogaria rrjedhëse në depozitë.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se pavarësisht se nuk e ka deklaruar llogarinë në deklaratën “Vetting”, nuk ka pasur për qëllim ta fshehtë apo ta paraqesë në mënyrë të pasaktë, për sa kohë që së bashku me këtë deklaratë ka depozituar edhe nxjerrjen e llogarisë së tij bankare në “Raiffeisen Bank”.

ii. Subjekti ka depozitë në shumën 10.000.000 lekë.

Referuar shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.1.2020, të “Raiffeisen Bank”, nga nxjerrjet e llogarive në emër të subjektit Agim Dalipaj, rezulton si vijon:

a. llogaria nr. ***-All-***-**-***, në monedhën lekë është përdorur si llogari page nga viti 2005 e në vazhdim;

b. në datën 21.4.2005 kjo llogari rezulton me gjendje 37.090 lekë, teprica e llogarisë në datën 23.12.2005 është 575.902,48 lekë.

Subjekti, një pjesë të gjendjeve të tij nga kjo llogari i ka kaluar si shtesa në depozitë për çdo vit për periudhën 2006 – 2018.

Në datën 19.4.2019 shuma totale prej 12.001.020 lekësh është mbyllur në depozitë me afat 12-mujor.

28.2. Analiza financiare – tabela nr. 4

Përshkrimi	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
1. Pasuri	2,859,227.59	634,723.04	788,436.73	941,291.89	251,083.30
2. Detyrime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3. Pasuri <i>neto</i>	2,859,227.59	634,723.04	788,436.73	941,291.89	251,083.30
4. Të ardhura	1,407,833.67	1,633,086.44	1,735,255.69	2,061,236.01	2,267,175.45
5. Shpenzime	974,393.49	629,290.40	628,188.00	723,054.70	546,480.00
6. Të ardhura <i>neto</i>	433,440.18	1,003,796.04	1,107,067.69	1,338,181.31	1,720,695.45
Mundësia për kursime	-2,425,787.41	369,073.00	318,630.96	396,889.42	1,469,612.15

Tabela nr. 5

Përshkrimi	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
1. Pasuri	1,246,752.09	4,592,662.62	1,073,375.32	1,244,968.72	776,383.78	605,150.03
2. Detyrime	0.00	3,271,171.00	-168,000.00	-168,000.00	-168,000.00	-168,000.00
3. Pasuri <i>neto</i>	1,246,752.09	1,321,491.62	1,241,375.32	1,412,968.72	944,383.78	773,150.03
4. Të ardhura	2,422,571.42	2,515,066.41	2,332,719.92	2,194,421.95	2,435,118.91	2,248,998.49
5. Shpenzime	725,381.73	773,659.02	619,100.40	1,240,414.54	1,312,125.21	1,379,833.30
6. Të ardhura <i>neto</i>	1,697,189.69	1,741,407.39	1,713,619.52	954,007.41	1,122,993.70	869,165.19
Mundësia për kursime	450,437.6	419,915.77	472,244.20	-458,961.31	178,609.92	96,015.16

28.2.1. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe të shtesave në depozitën në “Raiffeisen Bank” në vitin 2014, në shumën 458.961,31 lekë. Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me këtë rezultat.

28.2.2. Në shpjegimet e tij, subjekti sqaroi se bileta e udhëtimit vajtje-ardhje për në Itali të bashkëshortes me fëmijët është prenotuar e paguar në dhjetor të vitit 2013 nga motra e

bashkëshortes E. V (D) dhe nuk duhet të llogaritet si shpenzim. Subjekti kërkon që shpenzimet për vajzën e tij të mos përfshihen në shpenzimet jetike, për sa kohë sipas tij e bija ka konsumuar mëngjesin dhe drekën të përfshira në pagesën mujore të shkollës. Gjithashtu, deklaroi se nuk ka pasur shpenzime për veshje, pasi uniforma është bërë në vitin e parë dhe është përdorur deri në fund të shkollimit; librat ishin pronë e shkollës dhe nuk bliheshin, por përdorreshin brenda ambientit të shkollës. Subjekti vijon duke deklaruar se nëna e tij i ka dhënë çdo muaj vajzës së tij të holla, meqenëse në këtë vit kishte sjellë nga Italia shumë prej 1.00.000 lekësh. Subjekti ka deklaruar se këtë vit ka pakësuar gjendje *cash* në shumë 200.000 lekë në vitin 2014.

28.2.3. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson të marrë në konsideratë shpjegimet e tij në lidhje me pakësimin e gjendjes *cash* dhe të biletës së udhëtimit, ndërkohë në lidhje me shpenzimet e vajzës ato nuk mund të zbriten nga analiza financiare, pasi shpenzimet e arsimimit privat nuk mund të argumentohen se janë pjesë e shpenzimeve bazike të jetesës. Në kushtet kur ky shërbim në Republikën e Shqipërisë ofrohet me shpenzime modeste nga institucionet publike, i njëjti shërbim i ofruar nga biznese private është në mënyrë përkufizuese përtej nivelit bazik të jetesës së marrë për bazë në përlllogaritjet e institucioneve të rivlerësimit sipas informacionit të përcjellë nga INSTAT-i. Shpenzimet bazike që përlllogariten sipas INSTAT-it janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagat mujore të këtushme. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore. Për këto arsye, këto pretendime të subjektit u gjetën të pabazuara. Në lidhje me pretendimin e subjektit se nëna e tij i ka dhënë të holla vajzës, konsiderohet i pambështetur në prova, për më tepër nuk rezulton që subjekti në deklaratën “Vetting”, por edhe gjatë hetimit, të ketë deklaruar që nëna e tij i ka mbështetur me të ardhura. Pas rillogaritjes së vitit 2014 balanca negative e fondeve për këtë vit është 190.000 lekë. Kjo balancë negative nuk është e mjaftueshme që të passjellë zbatimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analizë kritike, por duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

DEKLARIM I BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT/F.D – DEKLARIMI I PASURIVE

29. Automjet tip “Volkswagen Polo”²⁰, blerë më 7.10.2011, në vlerën 500 euro – pjesa takuese: 100 %

Burimi sipas deklaratës “Vetting: të ardhurat nga paga.

Hetimi²¹ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

29.1. Bashkëshortja e subjektit ka blerë automjetin tip “Volkswagen Polo”²² nga shtetasi G.M, bazuar në deklaratën e aktit të njohjes, nëpërmjet të cilit deklarohet se ky shtetas i ka shitur bashkëshortes së subjektit automjetin tip “Volkswagen Polo” për shumë 500 euro. Nga dokumentacioni i automjetit në DPSHTRR rezulton se bashkëshortja e subjektit ka paguar edhe detyrimet doganore në shumë 21.613 lekë.

Në datën 6.2.2019, me kontratën nr. ***, bashkëshortja e subjektit e ka shitur këtë automjet (prodhim i vitit 1996) për shumë 100.000 lekë.

Nga analiza financiare rezulton se bashkëshortja e subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit.

²⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: deklaratë e aktit të njohjes nga pala shitëse G. M dhe pala blerëse F. D; leje qarkullimi në emër të znj. F.D të automjetit me targa AA *** BF.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.1.2020, e DPSHTRR-së; shkresë nr. *** prot., datë 10.3.2021, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.3.2021, e DPSHTRR-së.

²² Deklaruar në DVP/2011.

29.2. Nga hetimi ka rezultuar se në datën 6.2.2019, me kontratën nr. ***, bashkëshortja e subjektit ka blerë automjetin tip “Volkswagen” (prodhim i vitit 2014), në shumën 12.990 euro. Paguesa për këtë automjet është kryer në datën 4.2.2019, në shumën 905.000 lekë nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në “Raiffeisen Bank” dhe në datën 6.2.2019, në shumën 700.000 lekë nga llogaria e subjektit në të njëjtën bankë.

Nga analiza financiare rezulton se bashkëshortja e subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit.

Tabela nr. 6

	Data 6.2.2019
PASURI	-760,788.67
Autoveturë “Volkswagen Polo”, F.D	1,581,792.30
Shtesa/pakësime, likuiditete	-2,342,580.97
DETYRIME	0.00
PASURI NETO = PASURI - DETYRIME	-760,788.67
TË ARDHURA, dokumentuar	849,745.56
Të ardhura nga paga e subjektit	769,866.56
Të ardhura nga paga e bashkëshortes së subjektit	79,879.00
SHPENZIME	367,096.39
Shpenzime jetese	177,805.41
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	139,426.65
Shpenzime shkollimi	49,864.33
Mundësia për kursime	1,243,437.84

Në përfundim të analizës për këtë pasuri nuk kanë rezultuar dyshime apo paqartësi.

30. Depozitë bankare²³ në shumën 905.210 lekë në “Raiffeisen Bank” – pjesa takuese: 100 %

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat nga paga.

Hetimi²⁴ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

30.1. Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” rezulton se bashkëshortja e subjektit ka depozitë në shumën 905.200 lekë.

30.1.1. Në DVP/2003 subjekti deklaron “depozitë të kursyera” në Bankën e Kursimeve. Shuma: 600.000 lekë. Burimi: kursime.

Nga analiza financiare në vijim rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite.

Tabela nr. 7

	1984-1993	Viti 1994	Viti 1995	Viti 1996	Viti 1997	Viti 1998	Viti 1999
TË ARDHURA, dokumentuar	162,820.00	116,624.00	179,835.00	236,686.00	362,751.33	550,711.00	549,146.00
Të ardhura nga paga e subjektit	162,820.00	116,624.00	179,835.00	236,686.00	250,754.00	345,311.00	372,275.00

²³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogarie bankare datë 23.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”.

²⁴ Shkresë nr. ** prot., datë 17.1.2020, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.1.2020, e “Raiffeisen Bank”; shkresë nr.*** prot., datë 10.3.2021, drejtuar “Raiffeisen Bank”; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 31.3.2021, e “Raiffeisen Bank”.

Të ardhura nga paga e bashkëshortes	-	-	-	-	111,997.33	205,400.00	176,871.00
SHPENZIME	107,461.20	76,971.84	118,691.10	156,212.76	239,415.88	363,469.26	362,436.36
Shpenzime jetese	107,461.20	76,971.84	118,691.10	156,212.76	239,415.88	363,469.26	362,436.36
Mundësia për kursime	55,358.80	39,652.16	61,143.90	80,473.24	123,335.45	187,241.74	186,709.64

Tabela nr. 8

	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003
TE ARDHURA, dokumentuar	659,846.00	771,070.00	758,989.00	870,168.00
Të ardhura nga paga e subjektit	407,002.00	491,100.00	506,660.00	554,601.00
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	252,844.00	279,970.00	252,329.00	315,567.00
SHPENZIME	324,000.00	324,000.00	375,576.00	375,856.00
Shpenzime jetese	324,000.00	324,000.00	375,576.00	375,856.00
Mundësia për kursime	335,846.00	447,070.00	383,413.00	494,312.00

30.1.2. Referuar shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.1.2020, të “Raiffeisen Bank” nga nxjerrjet e llogarive në emër të bashkëshortes së subjektit rezulton se në datën 1.10.2004 ka gjendje me vlerë 670.854,77 lekë. Në datën 18.1.2006 bashkëshortja e subjektit çel depozitë në shumën 695.290,23 lekë. Kjo shumë është investuar disa herë në depozita dhe në datën 25.2.2016 ka qenë në vlerën 905.200 lekë.

Nuk kanë rezultuar dyshime apo paqartësi nga hetimi.

30.2. Nga nxjerrja e llogarisë së nënës së subjektit ka rezultuar se:

i. Nëna e tij pasur një depozitë në shumën 3.505.376 lekë në “Raiffeisen Bank” në datën 1.10.2011.

Në lidhje me këtë depozitë subjekti ka deklaruar se burimi i saj janë paratë e sjella nga vëllai i tij S. D, i cili ka qenë i punësuar në Itali dhe vazhdon të jetojë aktualisht. Duke marrë në konsideratë faktin se një pjesë e kësaj shume, sipas deklarimeve të subjektit, është përdorur për rikonstruktimin e apartamentit të nënës së tij (ku në fakt ai ka pjesë takuese), subjektit i është kërkuar të vendosë në dispozicion dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait të tij. Në përgjigje të pyetësorit të datës 4.5.2021 subjekti ka vënë në dispozicion skedën e regjistrimit profesional, nga ku rezulton se vëllai i tij ka punuar me ndërprerje nga viti 1996 deri aktualisht në shtetin italian, por nuk përcaktohet paga e përfutur prej tij, si dhe pagimi i detyrimeve tatimore.

Për sa më sipër, subjekti nuk provon me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të depozitës të krijuar nga nëna e tij në datën 1.10.2011, një pjesë e të cilës ka shërbyer për rikonstruktimin e apartamentit ku ai është bashkëpronar. Për këtë subjektit iu kalua barra e provës, ku në përgjigje të saj paraqiti dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e vëllait në shtetin italian. Bazuar në dokumentin ekstrakt i llogarisë për sigurimet, i datës 28.5.2021, provohet që vëllai i tij ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite, pasi ka përfutur të ardhura për vitet 1998 - 2011, në total 185.870 euro.

ii. Nëna e subjektit ka depozituar:

- në datën 19.6.2014, shumën 450.000 lekë;

- në datën 22.5.2017, shumën 1.500.000 lekë dhe si burim janë deklaruar kursime pensioni *belluno*, Itali.

Në lidhje me këto shuma subjekti ka depozituar dokumentacion në gjuhën italiane nga ISSH-ja e shtetit italian, nga ku rezulton se nëna e tij është trajtuar me pension pleqërie, si vijon:

Tabela nr. 9

Periudha	Viti 2016	Viti 2015	Viti 2014	Viti 2013	Viti 2012
Janar	512.71	545.00	549.00	551.00	-
Shkurt	514.65	538.00	548.00	545.00	-
Mars	543.71	542.00	549.00	545.00	-
Prill	612.00	541.00	548.00	546.00	-
Maj	543.71	542.00	549.00	545.00	3,227.00
Qershor	543.71	541.00	548.00	545.00	533.00
Korrik	543.71	541.39	549.00	545.00	532.00
Gusht	543.71	541.52	548.00	545.00	533.00
Shtator	543.71	510.52	549.00	545.00	532.00
Tetor	543.71	510.52	548.00	546.00	533.00
Nëntor	543.71	510.52	549.00	545.00	533.00
Dhjetor	1,087.42	1,057.00	1,097.00	1,090.00	1,065.00
Totali në euro	7,076.46	6,920.47	7,131.00	7,093.00	7,488.00
<i>Kursi i këmbimit Euro/lekë</i>	<i>135.23</i>	<i>137.28</i>	<i>140.14</i>	<i>140.20</i>	<i>139.59</i>
Totali në lekë	956,949.69	950,042.12	999,338.34	994,438.60	1,045,249.92

Të dyja shumat e mësipërme, në total 1.947.844,52 lekë, janë transferuar nga bashkëshortja e subjektit²⁵ në datën 14.11.2019 në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank”, me emërtim “kalim nga llogaria e vjehrrës, kursime nga pensionet në IT, ALB për përdorim të nevojave shëndetësore”.

Në lidhje me këtë transferim subjekti ka sqaruar²⁶ se në muajin gusht të vitit 2019 mamaja e tij u përkeqësua nga gjendja shëndetësore dhe e kalonte pjesën më të shumtë të kohës në spitale [...]. Filloi të mos ishte më e mundur të lëvizte pa shoqëruar dhe në nëntor të vitit 2019 vendosi të transferonte shumën që ajo kishte në llogari të saj në llogari të bashkëshortes së tij në mënyrë që të kishte mundësi të tërhiqte sa herë kishte nevojë. Fatkeqësisht ajo u nda nga jeta në 8 dhjetor të vitit 2019 dhe kjo shumë që ndodhet në këtë llogari deri në momentin që të hapen kufijtë dhe të vijnë motra dhe vëllai nga Italia do të bëhet përpjesëtimi në 5 pjesë.

Shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë transferim nuk janë bindëse, pasi:

- transferimi nga llogaria e nënës tek llogaria e bashkëshortes nuk është kryer nga nëna por nga bashkëshortja e tij;
- është e paqartë arsyeja pse duhej të kryhej kjo transfertë 1 muaj përpara se nëna e subjektit të ndërronte jetë dhe kur këto të ardhura do të duhej t'i nënshtroheshin regjimit të trashëgimisë;
- duke qenë se bashkëshortja e subjektit ka qenë e pajisur me prokurë të posaçme, ka pasur të gjitha mundësitë të kryente veprime në llogarinë e nënës së tij, pa qenë nevoja që shumat të transferoheshin në llogarinë e saj.

Rezultojnë të paqarta veprimet e bashkëshortes së subjektit në lidhje me transferimin e shumës 1.947.844,52 lekë nga llogaria bankare e znj. K. D te llogaria e znj. F.D. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë rezultat.

²⁵ Prokurorë e posaçme nr. ****, datë 25.10.2019.

²⁶ Shihni pyetësin datë 11.3.2021.

30.3. Në parashtrimet e tij subjekti nuk ka arritur të shpjegojë veprimet e kryera nga bashkëshortja në lidhje me këtë depozitë. Komisioni vlerëson që për sa kohë kemi të bëjmë me veprime të kryera pas deklaratës “Vetting” dhe me burim të ligjshëm, siç është provuar më lart, kjo paqartësi nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit, për sa kohë nuk ngrihen dyshime për fshehje pasurie.

31. Llogari në vlerën 160 euro në “Veneto Bank” – pjesa takuese 100 %

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat nga paga.

Hetimi²⁷ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

Bazuar në shkresën e “Intesa Sanpaolo Bank” (e cila ka përthithur “Veneto Bank”) konfirmohet që bashkëshortja e subjektit ka pasur llogari në euro me gjendje në datën 29.12.2016, në shumën 306,41 euro, si dhe detyrim nga karta e kreditit në datën 25.1.2017, në shumën 123,72 euro.

Rezulton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar.

32. Llogari në “ProCredit Bank”²⁸ në emër të shtetases S. D, në shumën 18.777,16 lekë (që nga viti 2006) dhe në emër të shtetasit A. D, në shumën 15.623,95 lekë (që nga viti 2006)

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat nga paga.

Hetimi²⁹ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

Bazuar në shkresën e “ProCredit Bank” rezulton se shtetasi A. D ka depozitë në shumën 17.259,62 lekë dhe shtetasja S. D ka depozitë në shumën 20.972,68 lekë.

Rezulton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar.

33. Në DVP/2017 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se ka në pronësi:

- a) shtëpi banimi me sip. 84 m² në Shëngjin;
- b) shtëpi banimi me sip. 81 m² në Shëngjin;
- c) njësi shërbimi me sip. 100 m² në Shëngjin.

33.1. Në DVP/2018 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se është bashkëpronare e një banese në qytetin e Shëngjinit me nr. hipotekor ***, datë 27.7.2018 (përfituar nga dhënia e truallit të banesës së prindërve një firme ndërtimi).

33.2. Nga hetimi në lidhje me këto pasuri ka rezultuar se:

i. Bashkëshortja e subjektit ka qenë bashkëpronare me 1/12 pjesë takuese të pasurive:

- njësi me sip. 100 m², me nr. pasurie ***-N*, z. k. ***, Lezhë, Shëngjin;
- apartament me sip. 81 m², me nr. pasurie ***+*-**, z. k. ***, Lezhë, Shëngjin;
- apartament me sip. 84 m², me nr. pasurie ***+*-*, z. k. ***, Lezhë, Shëngjin.

ii. Në datën 5.7.2018, me kontratën e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme nr. *** “apartament, njësi” bashkëshortja e subjektit, së bashku me familjarët e saj, i kanë ndarë pasuritë e mësipërme si vijon:

- apartamenti me sip. 84 m² dhe njësia me sip. 100 m² i mbetet shtetasit I. D(vëllai i bashkëshortes së subjektit);

²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.2.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

²⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie të “ProCredit Bank” për shtetasit S. D dhe A.D.

²⁹ Shkresë nr. ** prot., datë 17.1.2020, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigje nr. OP-***, datë 31.1.2020, e “ProCredit Bank”.

- apartamenti me sip. 81 m² mbetet në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit, motrave dhe nënës së saj.

iii. Burimi i pasurive të mësipërme ka qenë nga trashëgimia e të ndjerit S.D.

Nga hetimi në lidhje me burimin e krijimit, ka rezultuar se:

- Subjekti, në përgjigje të pyetësorit datë 11.3.2021, ka vënë në dispozicion:
 - vërtetimin e vitit 1997 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, ku vërtetohet se sipërfaqja e tokës truall në të cilën ndodhen shtëpitë dhe muret rrethuese të shtetasve J. J dhe S.D nuk i janë kthyer ndonjë pronari;
 - kontratë privatizimi, sipas së cilës në datën 26.7.1993 babai i bashkëshortes së subjektit ka privatizuar një banesë, kati i parë, e përbërë nga dy dhoma dhe një kuzhinë.
 - vërtetim nga dokumenti hipotekor, ku rezulton se kjo pasuri është regjistruar me nr. **+*-* YK ***, me sip. 106,3 m², lloji i pasurisë “truall”, nga e cila ndërtesë prej 77,9 m².
- Në datën 10.7.2007, me kontratën nr. ***, shtetasi S.D (babai i bashkëshortes së subjektit), së bashku me shtetasin J.J, kanë dhënë për ndërtim një banesë në qytetin e Shëngjinit, të përbërë nga dy apartamente *+* dhe një lokal me sip. 100 m². Në këmbim do të përfitonin secili 100 m² lokal në katin përdhes dhe dy apartamente *+* në pjesën ballore të objektit.
- Në datën 23.8.2008 është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. ***, ku sipas së cilës shtetasi S.D përfiton një lokal me sip. 100 m² në katin përdhes, si dhe dy apartamente: në katin e parë të banimit apartamenti nr. * me sip. 92,74 m²; dhe në katin e pestë të banimit apartamenti nr. ** me sip. 89,42 m². Çmimi konsiderohet i likuiduar, pasi pala porositëse është pronar i një pjesë të truallit ku është ngritur pallati.
- Në datën 29.10.2015 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. *** për të ndjerin S. D, sipas së cilës bashkëshortja e subjektit është trashëgimtare e radhës së parë dhe trashëgon 1/6 pjesë takuese.

Nuk rezultojnë dyshime apo paqartësi në lidhje me këto pasuri.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

34. Komisioni shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar, përgjigjet dhe provat e paraqitura nga subjekti për pyetësorët e dërguar, si dhe provat e parashtrimet në përgjigje të barrës së provës.

34.1. Në përfundim konstatohet se subjekti/personi i lidhur me të: (i) nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit të apartamentit në qytetin e Lezhës, në shumën 409.442 lekë; (ii) ka qenë kontradiktor në deklaratimet e tij në lidhje me kohën e fillimit të jetesës në apartamentin në Lezhë; (iii) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” në mënyrë të plotë dhe të saktë burimet që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament në njësinë administrative Shëngjin; (iv) ka kryer deklaratim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me apartamentin e ndodhur në njësinë administrative Shëngjin; (v) subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament të ndodhur në Shëngjin, në shumën 2.328.815,32 lekë; (vi) në kushtet kur subjekti në vitin 2002 ka hetuar çështjen nr. ***, me të pandehur z. L.Rr, ndërkohë që: (a) kishte porositur një apartament te shoqëria në të cilën z. Rr ishte ortak i vetëm; (b) kishte marrëdhënie shoqërore me këtë shtetas; si dhe (c) sipas pretendimeve të tij i kishte dhënë hua një shumë të konsiderueshme z. L. Rr, ai gjendet në situatën e konfliktit të interesit, bazuar në nenet 17/1 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale.

34.2. Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se:

- subjekti ka kryer deklaratim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;

- ii. subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurisë apartament në njësinë administrative Shëngjin, si dhe mobilimin e apartamentit në qytetin e Lezhës, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;
- iii. subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit, në kuptim të germës “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

34.3. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Agim Dalipaj, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

35. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Agim Dalipaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

35.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin³⁰ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Agim Dalipaj, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

35.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

35.3. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, z. Agim Dalipaj.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

36. Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, kërkohet që gjithnjë duhet të kryhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin lehtësisht të ndikueshëm prej tij.

37. Nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

38. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit, z. Agim Dalipaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

³⁰ Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

39. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme³¹;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura në Komision.

Raporti i hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe analiza e Komisionit

40. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore, të dorëzuara nga subjekti, konstatohen këto gjetje:

40.1. Vendim për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. **, të vitit 2016

40.1.1. Me vendimin datë 28.8.2016, subjekti i rivlerësimit ka pushuar hetimet për procedimin penal nr. **, të vitit 2016, regjistruar për veprat penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetases Zyra I. Baza ligjore: germa “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale.

Në vendim, subjekti ka arsyetuar shkaqet ligjore të pushimit të çështjes. Nga mënyra si është formuluar, vendimi i pushimit paraqitet i paqartë, me analizë dhe arsyetim konfuz, që nuk i përgjigjet qartë konkluzionit të arritur. Rezulton se në vendim nuk pasqyrohen qartësisht rrethanat e faktit penal. Subjekti i ka kushtuar më tepër rendësi analizës së provave, duke anashkaluar paraqitjen e hollësishme dhe qartësisht të kuptueshme të rrethanave të faktit. Në pjesën konkluduese të vendimit subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, për të cilën është regjistruar procedimi për të arritur në konkluzionin se veprimet nuk përbëjnë vepër penale.

Përveç sa sipër, në vendimin për pushimin e çështjes subjekti i rivlerësimit ka përdorur germa “a” dhe “b” të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale. Germa “a” parashikon pushimin e çështjes kur fakti nuk ekziston, ndërsa germa “b” parashikon pushimin e çështjes kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në vendim nuk bëhet një analizë se përse procedimi penal duhet të pushohet duke u bazuar në këto dy germa të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale. Nga sa konstatohet në vendimin e pushimit, në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me një fakt dhe, për pasojë, pushimi duhet të mbështetet vetëm në një nga germa të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale.

Në vendim, në dispozitiv, ka edhe një lapsus, pasi ndonëse vendimi i pushimit është për procedimin penal nr. **/2016, prokurori ka shënuar numrin e procedimit ***.

40.1.2. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për këtë dokument, si vijon:

- i. subjekti nuk ka analizuar elementët e veprës penale të shpërdorimit të detyrës;
- ii. vendimi i pushimit nuk është i argumentuar qartë dhe në mënyrë të plotë;
- iii. në vendim nuk pasqyrohen qartësisht rrethanat e faktit penal;
- iv. baza ligjore e përdorur nga subjekti nuk është e saktë, pasi germa “a” dhe “b” të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale përjashtojnë njëra-tjetrën.

40.1.3. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se *ky procedim është filluar në datën 30.5.2016 dhe në datën 28.8.2016 prej tij është vendosur pushimi i hetimeve [...]. Në fillim të pjesës konstatuese të vendimit të pushimit ka parashtruar të gjitha rrethanat e fakteve që ka pretenduar kallëzuesi, më pas ka parashtruar veprimet hetimore dhe në fund ka parashtruar rezultatet e hetimit për të gjitha shkeljet e pretenduara nga kallëzuesi [...]. Si bazë ligjore ka vënë germa “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, pra faktet për të cilat pretendohej nga kallëzuesi nuk ekzistonin dhe nuk parashikohen në ligj si vepër penale.*

³¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2019

40.1.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga mënyra si është formuluar, vendimi i pushimit paraqitet i paqartë, me analizë dhe arsyetim konfuz, që nuk i përgjigjet qartë konkluzionit të arritur. Rezulton se në vendim nuk pasqyrohen qartësisht rrethanat e faktit penal. Subjekti i ka kushtuar më tepër rëndësi analizës së provave, duke anashkaluar paraqitjen e hollësishme dhe qartësisht të kuptueshme të rrethanave të faktit. Në pjesën konkluduese të vendimit subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, për të cilën është regjistruar procedimi penal, duke i ballafaquar me veprimet konkrete të personit nën hetim të rezultuara nga hetimi i çështjes, për të arritur në konkluzionin se veprimet nuk përbëjnë vepër penale. Baza ligjore e përdorur nuk është e saktë. Germat “a”³² dhe “b”³³ të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale përjashtojnë njëra-tjetrën, pasi nëse fakti nuk ekziston ai përjashton germën “b”, e cila ka si domosdoshmëri ekzistencën e faktit.

Komisioni çmon se në këtë dokument ligjor evidentohet se subjekti ka treguar aftësi dhe gjykim të dobët, pasi ka mangësi në arsyetimin e vendimit, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga pika 3 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

40.2. Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. *, të vitit 2013**

40.2.1. Në datën 17.2014, subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka përpiluar kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në ngarkim të të pandehurit P (F) D, i akuzuar për veprat penale “vrasje me paramendim” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”, me pasojë të rëndë, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 278/5 të Kodit Penal.

Kërkesa mbështetet në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale dhe përmban përgjithësisht strukturën dhe elementët e përcaktuar dhe kërkuar nga kjo dispozitë procedurale. Në pjesën e parë të kërkesës paraqiten në mënyrë korrekte, të hollësishme dhe sipas kërkesave të ligjit të dhënat për të pandehurin, gjeneralitetet dhe adresat e vendndodhjes së tij, të cilat i shërbejnë gjykatës për identifikimin dhe njoftimin e të pandehurit për gjykim dhe akuza ndaj tij. Në pjesën e dytë të kërkesës, ku pasqyrohen fakti dhe rrethanat e tij, provat dhe burimi i tyre, konkluzionet paraqiten me një strukturë jo të qartë dhe të kuptueshme. Rezulton se nuk janë parashtruar rrethanat e faktit. Në këtë pjesë të konkluzioneve, prokurori është përqendruar vetëm në pasqyrimin e rrethanave të regjistrimit të procedimit penal dhe paraqitjen e provave. Në këtë pjesë, subjekti pasqyron përmbajtjen e deklarimeve të dëshmitarëve të pyetur gjatë hetimit, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme pohimet e tyre, çka nuk është e nevojshme dhe nuk kërkohet nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale për përpilimin e kërkesës për gjykim. Kjo dispozitë, në germën “c” të pikës 2, kërkon që në kërkesën për gjykim duhet të paraqiten burimet e provës dhe faktet që ato u referohen, pa i analizuar dhe pa i cituar apo ekspozuar hollësisht përmbajtjen e tyre.

Nga analizimi i kërkesës për gjykim ngrihen dyshime edhe për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, por që nuk rezulton të jetë hetuar nga subjekti.

40.2.2. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për këtë dokument, si vijon:

- i. Kërkesa për gjykim nuk është e argumentuar plotësisht, pasi nuk janë parashtruar rrethanat e faktit, si dhe konkluzionet paraqiten me një strukturë jo të qartë dhe nuk janë të kuptueshme.
- ii. Subjekti nuk ka hetuar të pandehurin në lidhje me veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.
- iii. Subjekti pasqyron përmbajtjen e deklarimeve të dëshmitarëve të pyetur gjatë hetimit, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme pohimet e tyre, çka nuk është e nevojshme dhe

³² Del qartë se fakti nuk ekziston.

³³ Fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

nuk kërkohet nga neni 331/2³⁴ i Kodit të Procedurës Penale për përpilimin e kërkesës për gjykim.

40.2.3. Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka sqaruar se në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes nuk rezultoi që të jenë gjetur sende të kundërligjshme, përveç atyre që bëjnë fjalë vetëm për vrasjen, ndërsa për lëndë narkotike nuk ka [...]. Lidhur me parashtrimin në kërkesë për gjykim të dëshmitarëve të deklarimeve të tyre kjo, është bërë saktë, pasi mbi 95 % të gjykimeve bëhen me procedurë të gjykimit të shkurtuar dhe në praktikën e përditshme të gjithë prokurorët parashtrajnë provat me dëshmitarë pastaj provat shkencore dhe në përfundim arrihet në konkluzionin se për çfarë akuzohet...

40.2.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në faqen 3 të dokumentit “kërkesë për gjykim” gjendet deklarimi i shtetasit F. N (punonte si çoban për llogari të viktimës), i cili, ndër të tjera, ka deklaruar se gjatë kohës që ka kullotur bagëtitë e M në fshatin Gj rreth 20 minuta larg nga shtëpia e tij në këmbë ka qenë e mbjellë një parcelë me bimë narkotike *canabis sativa*, të cilën ka parë që e vadisnin F (P) i pandehuri dhe gruaja e parë e M (viktimës) [...] ka para F (P) duke mbushur një thes me bimë narkotike *canabis sativa*.

Bazuar në deklaratimet e këtij shtetasi subjektit duhet të kishte zgjeruar hetimet dhe për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, veprim i cili nuk është kryer prej tij.

Në lidhje me përmbajtjen e dokumentit “kërkesë për gjykim” konstatohet se konkluzionet paraqiten me një strukturë jo të qartë dhe të kuptueshme. Subjektit nuk ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, ndërkohë që ka paraqitur në mënyrë të hollësishme pohimet e dëshmitarëve, çka nuk është e nevojshme dhe nuk kërkohet nga neni 331/2 i Kodit të Procedurës Penale për përpilimin e kërkesës për gjykim.

Komisioni çmon se në këtë dokument ligjor evidentohet se subjekti ka treguar aftësi, njohuri, gjykim të dobët, pasi evidentohen: (i) mangësi në drejtim të hetimit të plotë të çështjes dhe hetim i dobët nga subjekti; (ii) mangësi në arsyetimin e kërkesës për gjykim, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

40.3. Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. *, të vitit 2015**

40.3.1. Subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka përpiluar kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, në ngarkim të të pandehurit Q.B, i akuzuar për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal.

Procedimi penal ka të bëjë me ngjarjen e ndodhur në datën 7.7.2015 në fshatin V, në oborrin e banesës së shtetasit K.J, ku si pasojë e rënies në kontakt me rrymën elektrike ka gjetur vdekjen shtetasi A. H, elektrikist i OSSHE-së Tropojë.

Kërkesa mbështetet në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale dhe përmban përgjithësisht strukturën dhe elementët e përcaktuar dhe kërkuar nga kjo dispozitë procedurale. Në pjesën e parë të kërkesës paraqiten në mënyrë korrekte, të hollësishme dhe sipas kërkesave të ligjit të dhënat për të pandehurin, gjeneralitetet dhe adresat e vendndodhjes së tij, të cilat i shërbejnë gjykatës për identifikimin dhe njoftimin e të pandehurit për gjykimin dhe akuzat ndaj tij. Në pjesën e dytë të kërkesës, ku pasqyrohen fakti penal dhe rrethanat e tij, provat dhe burimi i tyre, konkluzionet paraqiten me një strukturë jo të qartë dhe janë vështirësisht të kuptueshme. Rezultoni se nuk janë parashtruar rrethanat e faktit. Në këtë pjesë të konkluzioneve subjekti është përqendruar vetëm në pasqyrimin e rrethanave të regjistrimit të procedimit penal dhe paraqitjen e provave. Në këtë pjesë, prokurori pasqyron përmbajtjen e deklarimeve të

³⁴ Kërkesa për gjykim përmban: (a) gjeneralitetet e të pandehurit dhe të dëmtuarit nga vepra penale; (b) parashtrimin e faktit, duke treguar nenet përkatëse të Kodit Penal; (c) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen; (ç) datën dhe nënshkrimin e prokurorit.

dëshmitarëve të pyetur gjatë hetimit, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme pohimet e tyre, çka nuk është e nevojshme dhe nuk kërkohet nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale për përpilimin e kërkesës për gjykim. Kjo dispozitë, në germën “c” të pikës 2, kërkon që në kërkesën për gjykim duhet të paraqiten burimet e provës dhe faktet që ato u referohen, pa e analizuar dhe pa e cituar ekspozuar hollësisht përmbajtjen e tyre.

40.3.2. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për këtë dokument, si më poshtë vijon:

- i. Kërkesa për gjykim nuk është e argumentuar plotësisht, pasi nuk janë parashtruar rrethanat e faktit, si dhe konkluzionet paraqiten me një strukturë jo të qartë dhe nuk janë të kuptueshme.
- ii. Subjekti pasqyron përmbajtjen e deklarimeve të dëshmitarëve të pyetur gjatë hetimit, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme pohimet e tyre, çka nuk është e nevojshme dhe nuk kërkohet nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale për përpilimin e kërkesës për gjykim.

40.3.3. Subjekti, pas kalimit të barrës provës, ka sqaruar se mendon se kërkesa për gjykim është përpiluar në zbatim të kërkesave të neneve 327 dhe 331 të Kodit të Procedurës Penale, ku është parashtruar fakti, çfarë ka ndodhur me datë, orë dhe vend, kjo sipas procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Pas kësaj ka vijuar me parashtrimin e provave me dëshmitar dhe ka parashtruar gjetjet e aktit të ekspertimit teknik. Në fund ka parashtruar gjetjet e hetimit se kush është autori i kryerjes së kësaj vepre penale dhe çfarë ka shkelur nga rregullorja e sigurimit teknik. Struktura e akteve është e qartë dhe e kuptueshme, pasi edhe gjykata me vendimin e saj ka bërë të njëjtat parashtrime siç i ka paraqitur në kërkesën për gjykim dhe konkluzione.

40.3.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga përmbajtja e dokumentit kërkesë për gjykim konstatohet se konkluzionet paraqiten me një strukturë jo të qartë dhe të kuptueshme. Subjekti nuk ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, ndërkohë që ka paraqitur në mënyrë të hollësishme pohimet e dëshmitarëve, çka nuk është e nevojshme dhe nuk kërkohet nga neni 331/2 i Kodit të Procedurës Penale për përpilimin e kërkesës për gjykim.

Komisioni çmon se në këtë dokument ligjor subjekti ka treguar njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohen mangësi në arsyetimin e kërkesës për gjykim, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pika 3 e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

41. Analiza e pesë dosjeve penale të përzgjedhura me short

41.1. Në vlerësim të këtyre dosjeve penale, Komisioni ka konstatuar problematika vetëm në lidhje me dy prej tyre.

41.2. Vendimi datë 26.1.2015, “Për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. **, të vitit 2014”, regjistruar në datën 22.1.2014, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

41.2.1. Në datën 8.10.2013 shtetasi S.A ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kallëzimin për kryerjen e veprave penale “falsifikim i dokumenteve”, “mashtrim” dhe “shpërdorim detyrë”, parashikuar përkatësisht nga nenet 186, 143 dhe 248 të Kodit Penal.

Shoqëria “A S&A” sh.p.k., me përfaqësues shtetasin S.A dhe shoqëria “U.L” sh.p.k., me përfaqësues shtetasin Gj.U kanë nënshkruar aktmarrëveshjen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.5.2008. Në përputhje me këtë marrëveshje të dyja shoqëritë kanë investuar për ndërtimin e një godine banimi, në pasurinë e paluajtshme me sip. 3.440 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, në Y, Tiranë. Pas ndërtimit rezultoi se janë shitur apartamente, ku në disa nga kontratat e shitjes ka firmosur shtetasi T.U, si përfaqësues i shoqërisë “U.L” sh.p.k. Në të gjitha këto kontrata është parashikuar se leja e ndërtimit është në emër të shoqërisë “A. S&A” sh.p.k., por në asnjë prej tyre nuk është në cilësinë e palës shitëse edhe shoqëria me administrator kallëzuesin S. A. Kontratat janë lidhur përpara noteres M.D në Lezhë.

Kallëzuesi S.A pretendon se në këto kontrata blerësit janë mashtruar, pasi u është dorëzuar në dorë fotokopja e një aktmarrëveshjeje të falsifikuar, sipas të cilës ndahen njësitë për shitje midis dy shoqërive. Kjo rrethanë pohohet edhe nga blerësit e apartamenteve, ku prezent në lidhjen e kontratës kanë qenë noterja M.D, shtetasi T.U dhe A. U, ku ky i fundit u ka dhënë në dorë blerësve fotokopjen e aktmarrëveshjes.

Aktmarrëveshja e falsifikuar me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.4.2009, është përpiluar pranë noteres Z.D dhe paraqet të dhëna të rreme në nënshkrimin e përfaqësuesit të shoqërisë “A S&A” sh.p.k., në nënshkrimin e përfaqësuesit të shoqërisë “U. L” sh.p.k., dhe në nënshkrimin e vulën e noteres Z.D.

Nga hetimi ka rezultuar se si në kontratat e paraqitura nga kallëzuesi, ashtu edhe në kontratat e marra prej noteres M.D, nuk përmendet marrëveshja e falsifikuar, por lidhja e tyre është bazuar në aktmarrëveshjen e lidhur realisht midis dy përfaqësuesve të subjekteve me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.5.2008.

Noterja M.D dhe shtetasit T.U e A.U pretendojnë se nuk janë në dijeni të aktmarrëveshjes së falsifikuar. Kontratat janë lidhur në përputhje me aktmarrëveshjen nr.*** rep., nr. *** kol., datë 6.5.2008, e cila nuk parashikon që kontratat e porosive të apartamenteve *duhet të bëhen me firmat e të dy shoqërive.*

Nga veprimet hetimore të kryera nuk është arritur të disponohet në origjinal aktmarrëveshja e falsifikuar nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.4.2009.

Me vendimin datë 27.6.2014, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka zëvendësuar prokurorin A.A “nga kryerja e hetimeve të çështjes penale nr. **, viti 2014, duke caktuar prokurorin Agim Dalipaj”.

Rezulton se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor deri në datën 26.1.2015, kur ka vendosur pushimin e çështjes pa kryer asnjë veprim hetimor me argumentin se *nuk mund të provohet se nga cili person është falsifikuar dokumenti aktmarrëveshje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.4.2000. Po kështu, nuk mund të kryhet as ekspertim grafik shkrimi, pasi ky dokument është fotokopje dhe nuk mund të vërtetohet shkencërisht me ekspertim grafik se dokumenti është falsifikuar.*

Vendimi bazohet në nenin 328, pika 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon pushimin e çështjes penale, kur del se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale.

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të një akti të kësaj natyre dhe rezulton i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese dhe argumentuese, duke u mbyllur me dispozitivin e tij për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Nga ana formale akti paraqitet i rregullt, përgjithësisht janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe paragrafët janë të ndërtuar drejt.

Vendimi përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit, por në vendim nuk pasqyrohen qartësisht rrethanat e faktit penal. Subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar më tepër rëndësi analizës së provave, duke anashkaluar paraqitjen e hollësishme dhe qartësisht të kuptueshme të rrethanave të faktit. Në pjesën arsyetuese të vendimit subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të falsifikimit të dokumentit.

Për pushimin e çështjes subjekti i rivlerësimit ka përdorur germën “b” të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon pushimin e çështjes kur fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Ndërkohë, sipas përmbajtjes së vendimit, pushimi i çështjes argumentohet se nuk arrihet të provohet kryerja e veprës penale (duke qenë se dokumenti është fotokopje), me rezervën se edhe nëse është kryer vepra penale nuk arrihet të provohet se kush është subjekti i kryerjes së saj. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të analizojë dhe argumentojë qartësisht arsyet e mungesës së elementëve të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Gjithashtu konstatohet mospërputhje logjike midis bazës ligjore, normës procedurale mbi të cilën prokurori mbështet vendimin e pushimit të procedimit penal dhe argumenteve të parashtruara në pjesën arsyetuese të vendimit. Prokurori argumenton se në rastin konkret nuk arrihet të provohet kryerja e veprës penale, ndërsa pushon çështjen, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale.

41.2.2. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me këtë procedim si më poshtë vijon:

- i. Subjekti ka vendosur pushimin e çështjes pas 6 muajsh pa kryer asnjë veprim hetimor.
- ii. Subjekti nuk ka arritur të analizojë dhe argumentojë qartësisht arsyet e mungesës së elementeve të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve.
- iii. Subjekti nuk ka pasqyruar qartësisht rrethanat e faktit penal.
- iv. Baza ligjore e referuar nga subjekti nuk përputhet me vendimin e pushimit, pasi ky i fundit argumenton se në rastin konkret nuk arrihet të provohet kryerja e veprës penale, ndërsa pushon çështjen, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale.
- v. Subjekti duhej të kishte vendosur pezullimin e hetimeve, për sa kohë pretendon se nuk mund të provohet se nga cili person është falsifikuar dokumenti.
- vi. Subjekti në vendim nuk analizon faktin se pse dy nga personat që kishin blerë apartamente kishin dokumentin e falsifikuar.
- vii. Subjekti nuk ka administruar kopjen e plotë të kontratave të shtetasve që kanë depozituar dokumentin e falsifikuar për të verifikuar nëse dokumenti kishte vulën e noterës që kishte hartuar kontratat midis shoqërisë dhe këtyre shtetasve.
- viii. Subjekti nuk ka hetuar në lidhje me faktin se si dokumenti i falsifikuar kishte vulën e noterës.
- ix. Subjekti nuk ka urdhëruar sekuestrimin nga arkiva e noterës së kontratave të sipërmarrjes për të verifikuar nëse në ndonjërin prej tyre ishte pjesë dokumenti objekt hetimi.

41.2.3. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se *te vendimi i pushimit fillimisht ka parashtruar pretendimet e kallëzuesit S.A dhe deklarimet e personave të përfshirë në shitblerjet e pallateve të shoqërive "A.S&A" sh.p.k. dhe "U.L" sh.p.k. dhe në përfundim të analizës dhe rezultateve të hetimit ka konkluduar se shkeljet e aktmarrëveshjes nga shoqëria "U.L" sh.p.k. janë të karakterit administrativo-civil dhe në lidhje me këto duhej që t'i drejtohej gjykatës.* Subjekti pranon se disa nga gjetjet janë të drejta, por pa specifikuar cilat.

41.2.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me këtë procedim konstatohen se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme. Nga ana e tij nuk është kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë 6-mujore dhe më pas është vendosur pushimi i procedimit, duke zvarritur në këtë mënyrë hetimet pa arsye. Subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të falsifikimit të dokumentit. Ai nuk ka arritur të analizojë dhe argumentojë qartësisht arsyet e mungesës së elementëve të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Gjithashtu konstatohet mospërputhje logjike midis bazës ligjore, normës procedurale mbi të cilën prokurori mbështet vendimin e pushimit të procedimit penal dhe argumenteve të parashtruara në pjesën arsyetuese të vendimit.

Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale subjekti ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohen: (i) mangësi në drejtim të hetimit të plotë të çështjes dhe hetim i dobët nga subjekti; (ii) mangësi në arsyetimin e vendimit të pushimit; si dhe (iii) zvarritje pa arsye të procedimit penal, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të neni 73 dhe pika 4 e neni 74 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

41.3. Vendimi datë 27.1.2016, "Për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. * të vitit 2015",** regjistruar në datën 7.12.2015, për veprën penale "shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal.

41.3.1. Në datën 7.12.2015, Komisariati i Policisë Tropojë ka referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë materialet në ngarkim të shtetasve A. H, E.M dhe shtetasit F. L, për veprën penale "shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.

Me vendimin datë 27.1.2015, subjekti, në cilësinë e prokurorit së çështjes, ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. **, të vitit 2014, me argumentin se *shtetasit A.H, E.M dhe F.L*

kanë zbatuar kërkesat e rregullave të sigurimit teknik në punë, pasi atë ditë kanë pasur urdhrin e punës për punëtorët, se ku do të punonin etj. Në kundërshtim me urdhrin e punës nga ana e të ndjerit është shkelur paragrafi 12, gerrat “a”, “c” dhe “e” të rregullores së teknikës së sigurimit në miniera e karriera. Pra, personat nuk mund të merren si të pandehur, pasi nuk kemi konsumimin e veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi penal dhe në këto rrethana nuk mund të vazhdojë ndjekja penale dhe ky procedim penal duhet të pushohet.

Vendimi bazohet në nenin 328, pika 1, gerrat “ç” dhe “d” të Kodit të Procedurës Penale.

Në vendim nuk janë parashtruar në mënyrë të qartë rrethanat konkrete të faktit, pasi subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar më tepër rëndësi analizës së provave, duke anashkaluar paraqitjen e hollësishme dhe qartësisht të kuptueshme të rrethanave të faktit. Gjithashtu, vendimi mbështetet në rrethana fakti të verifikuara pjesërisht dhe në mungesë të kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore për të arritur në një konkluzion të drejtë mbi ekzistencën ose jo elementëve të veprës penale.

Nga aktet e dosjes rezultojnë se:

- i. Nuk është sqaruar nëse viktima R. A ka qenë siguruar pranë organeve tatimore ditën e ndodhjes së aksidentit.
- ii. Nuk është sqaruar nëse nga punëdhënësi janë marrë masat e nevojshme të sigurimit teknik sipas rregullores së teknikës së sigurimit për minierat dhe karrierat për shmangien e aksidenteve dhe ngjarjeve që cenojnë jetën dhe shëndetin e punonjësve.
- iii. Nuk është sqaruar nëse viktima ka qenë i instruktuar (akti i instruktimit nuk rezultojnë i firmosur nga viktima R. A).
- iv. Më thelbësorja është se duhej që të ishte realizuar kryerja e një akti riekspertimi-teknik me grup ekspertësh, pasi akti i ekspertimit teknik, ku mbështetet vendimi i pushimit të çështjes nuk përmban të gjithë elementët që duhet të ketë një akt i tillë në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj.
- v. Baza ligjore e identifikuar nuk është e saktë.

Për arsyet e paraqitura më sipër, akti është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura. Konkluzionet e tij mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje. Në rrethanat e sipërpërmendura, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhet të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Subjekti i rivlerësimit nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkëlqes së rregullave të mbrojtjes në punë. Konkluzioni i subjektit, në aspektin arsyetues, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf.

Konstatohet mospërputhje logjike midis bazës ligjore, normës procedurale mbi të cilën prokurori mbështet vendimin e pushimit të çështjes dhe argumenteve të parashtruara në pjesën arsyetuese të vendimit. Gerrat “ç” dhe “d” të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale parashikojnë përkatësisht pushimin e çështjes kur “personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet” ose kur “ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë”. Ndërkohë, sipas përmbajtjes së vendimit, pushimi i çështjes argumentohet se në rastin konkret nuk janë “konsumuar elementët e veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi”. Nga sa konstatohet në vendimin e pushimit në rastin konkret, kemi të bëjmë vetëm me një fakt dhe, për pasojë, pushimi duhet të mbështetet vetëm në një nga gerrat e nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale. Referuar parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në pjesën arsyetuese të vendimit, pushimi duhet të bazohet vetëm në germen “b” të këtij neni, fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale.

41.3.2. Përveç sa ka konstatuar Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me këtë procedim, Komisioni konstaton se:

- vi. Vendimi nuk i është njoftuar familjarëve të viktimës.
- vii. Viktimës i kishte skaduar afati i dëshmisë së zjarrmëtarit.

Viktima ka qenë i punësuar me kontratë pune si minator zjarrmëtar për periudhën 1.2.2015 – 31.1.2016 dhe ka qenë i pajisur me leje zjarri nr. ***, datë 17.11.2010, me afat 5-vjeçar, pra, në momentin e ndodhjes së ngjarjes nuk ka pasur një dëshmi të vlefshme për ushtrimin e detyrës së tij. Ky fakt nuk është hetuar nga subjekti.

viii. Polica e sigurimit në grup nga aksidentet personale të punonjësve është bërë për 11 vetë për periudhën 12.6.2015 – 11.6.2016, ku përfshihet edhe viktima, por ndërkohë, bazuar në listëpagesën e periudhës qershor - gusht 2015 të punësuarit e kësaj shoqërie janë 45 vetë.

Subjekti nuk ka hetuar në lidhje me faktin se pse pjesa tjetër e punonjësve nuk ka qenë e siguruar.

ix. Subjekti nuk ka administruar listëpagesat për periudhën gusht 2015 – janar 2016³⁵ për të verifikuar deklarin në organet tatimore të viktimës.

x. Subjekti nuk ka hetuar faktin se pse punonjësit kanë punuar në ditë pushimi (data 6 është ditë e diel) dhe në mungesë të drejtuesit teknik të firmës “B” sh.p.k.

xi. Nga dosja hetimore mungon urdhri i punës i datës 6.1.2016, fakt i cili konfirmohet edhe nga deklarinimet e z. A.H në datën 7.12.2015, ku ai deklaron se: *“Porosi këto të dhëna me gojë nga ana e tij si drejtues”*.

Subjekti nuk ka hetuar faktin se si i janë dhënë porosi me gojë viktimës nga drejtuesi teknik ku ai deklaron se ka qenë pushim atë ditë.

xii. Subjekti nuk ka hetuar faktin se si drejtuesi teknik ka nxjerrë urdhrin e punës pa qenë prezent në punë.

xiii. Bazuar edhe në vendimin për vleftësimin e sekuestrës, datë 7.12.2015, rezulton se janë sekuestruar urdhrat e punës për periudhën 24.11.2015 – 5.12.2015, pra mungon urdhri i punës i datës 6.1.2016, kur ka ndodhur ngjarja. Subjekti në vendim i referohet faktit që viktima nuk ka respektuar urdhrin e punës.

xiv. Bazuar në deklarinimet e datës 22.12.2015, të shtetasit Z.A, ku deklaron se *viktima ka hyrë në zyrën e z. F.L dhe kur ka dalë i ka treguar se do punonin në frontin nr. **, ku është edhe vendi ku i ndjeri ndërroi jetë duke punuar aty. Gjatë periudhës që hynë në galeri për të punuar ka ardhur me to dhe z. F.L për të dhënë udhëzim me punën ditore, duke i sqaruar se do të punonin në frontin nr. ** dhe duhet ta mbaronin këtë front.*

xv. Ndërkohë shtetasi F.L, në deklarinimet e tij në datën 7.12.2015, deklaron se nuk e ka takuar fare viktimën.

Në lidhje me deklarinimet kontradiktore midis shtetasve F.L dhe Z.A është bërë një ballafaqim në datën 25.1.2016, ku shtetasi Z. A ka deklaruar se nuk e di arsyen se pse ka deklaruar më parë që rrugën për në frontin e punës e ka bërë së bashku me menaxherin F.L, por ndërkohë nuk ka mohuar pjesën tjetër të deklarinimeve.

Ky deklarim i shtetasit Z.A, dëshmitar i vetëm okular, nuk është analizuar në vendimin e pushimit nga subjekti, por është përfshirë pa asnjë analizë.

xvi. Subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit.

xvii. Sipas relacionit të datës 29.12.2015, të hartuar nga OPGJ-ja, sugjerohet që çështja të kalojë për gjykim me të pandehur shtetasit E.M dhe F. L për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Ky sugjerim mbështetet në faktin se *shtetasi F.L nuk ke ka zbatuar urdhrin e punës, pasi shtetasi Z. A e ka shprehur qartë se menaxheri i ka dhënë detyrën të punojë pikërisht në vendin ku ka ndodhur aksidenti. Kontrata e punës e nënshkruar mes administratorit E.M është për një periudhë më të gjatë se leja e zjarrmëtarit, e cila edhe pasi ka skaduar afati nuk është rinovuar dhe i ndjeri R. A ka vazhduar punën e njëjtës sipas kontratës.*

41.3.3. Në lidhje me këtë dosje, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, si më poshtë vijon:

³⁵ Kur ka ndodhur aksidenti.

- i. Subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuara më lart. Në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.
- ii. Subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë.

41.3.3.1. Për rrjedhojë, vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje.

41.3.3.4. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka deklaruar se në lidhje me faktin nëse ka qenë ose jo i siguruar në organet tatimore, ka sqaruar se: *“Polica e sigurimit datë 12.6.2015 deri më 11.6.2016, është bërë në grup për 45 vetë dhe në këtë listë ndodhet edhe emri i të ndjerit dhe këtë policë sigurimi e ka quajtur të rregullt e të saktë [...]. Është e vërtetë që në ballafaqimin midis z. Z.A dhe menaxherit F.L ka kontradikta, por ai e ka analizuar dhe përshkruar edhe deklarinimin dhe ballafaqimin. Është e vërtetë që urdhri i punës është i plotësuar deri në datën 5.12.2015, ndërsa për ditën e diel, datë 6.12.2015, nuk ka urdhër pune, por i komunikuar me gojë nga drejtori teknik i shoqërisë, A. H, menaxherit të objektit F.L, që ka qenë edhe mbikëqyrës i punimeve. Lidhur me këtë, ai mendon se për raste të rralla edhe mund të jepet urdhri me gojë nga drejtuesi teknik i cili ka munguar për arsye familjare, bashkëhartuesit të urdhrit, F, i cili ka qenë prezent në objekt. Këtë pretendim e mbështes tek urdhri i punës datë 4.12.2015, i cili është shumë i gjatë dhe shumë përshkruar për punimet që duhen bërë, kjo shoqëruar edhe me skica, ndërsa urdhri për datën 5.12.2015 është i firmosur nga të dy, drejtuesi teknik dhe menaxheri i objektit”.*

Lidhur me pajisjen e shoqërisë me të gjitha dokumentet si lejet, licencat dhe autorizimet që duhet të administroheshin, kjo gjetje e bërë është e drejtë, por ato janë parë nga ana e dy ekspertëve (specialist i drejtorisë së repartit shpëtim-miniera pranë ministrisë përkatëse të kohës), ku leja minerare mban numrin ***, datë 5.9.2009, nën administrimin e shoqërisë “B” sh.p.k., si dhe dokumentacionin ligjor e teknik që disponon ky subjekt dhe më pas të dy ekspertet kanë parashtruar përgjigjen e pyetjeve dhe me pas kanë dalë në konkluzionin e tyre rreth ngjarjes. Pra, ai është mjaftuar me këqyrjen e ekspertëve për këto dokumente që nuk janë administruar nga ana e tij. Është e vërtetë që kontrata e punës si minator - zjarrmëtar ka afat nga data 1.2.2015 deri më 31.1.2016, si dhe leja e zjarrmëtarit nr. ***, datë 17.11.2010, është e vlefshme për 10 vjet dhe jo për 5 vjet. Pra, edhe sikur ditën e ngjarjes të ndjerit t'i korrespondonte leja e zjarrmëtarit e skaduar, ai nuk ka shkuar për të kryer detyrën e zjarrmëtarit, por atë të minatorit. Lidhur me relacionin e hetimeve nga OPGJ-ja ku sugjeron për dërgimin e çështjes në gjyq, ai mendon se në praktikën e punës së prokurorit ka pasur shumë raste që nuk përputheshin sugjerimet e tyre me aktet që ndodhen në dosje, ku prokurori vendos ndryshe. Lidhur me gjetjen për riekspertimin teknik subjekti sqaron se në shumë raste organi i prokurorisë ka komunikuar me ekspertë të fushës për të bërë ekspertime të tilla ose të llojeve të tjera dhe nuk kanë pranuar për të bërë riekspertime me fjalët “nuk merremi me raste në Tropojë”. Në lidhje me geramat e vendosura prej tij gabimisht kanë ngelur nga një dokument tjetër mbi të cilin ka punuar. Subjekti ka deklaruar se disa nga gjetjet janë të drejta, por ai ka menduar se hetimi është i plotë dhe ka vendosur pushimin e hetimeve.

41.3.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga analizimi i fashikullit penal konstatohet se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme. Në vendimin e pushimit, por edhe në parashtrime, pretendon se nga i ndjeri është shkelur urdhri i punës, ndërkohë që ky urdhër mungon. Subjekti nuk ka argumentuar se ku është bazuar që i ndjeri ka shkelur urdhrin e punës, ndërkohë që pranon vetë që ky urdhër pune mungon. Subjekti nuk argumenton se pse nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, por deklaroi se ai mendonte se hetimi ka qenë i plotë, ndërkohë që ka pranuar që ky hetim nuk ka qenë i plotë. Subjekti nuk ka hetuar faktin se pse

punonjësit kanë punuar në ditë pushimi dhe në mungesë të drejtuesit teknik të shoqërisë “B” sh.p.k. Subjekti pretendon se ekspertë të fushës kanë refuzuar të kryejnë ekspertimin, por ndërkohë në dosje nuk gjendet asnjë urdhër riekspertimi apo refuzimi i ekspertëve të fushës për të kryer ekspertimin. Në lidhje me faktin që emri i të ndjerit ishte në policën e sigurimit nuk vërteton faktin se ai ka qenë i deklaruar në organet tatimore. Subjekti ka administruar disa listëpagesa, por jo të gjitha dhe pikërisht listëpagesat e periudhës në të cilën ka ndodhur aksidenti. Në lidhje me afatin e lejes së zjarrmëtarit, subjekti pretendon se është 10 vjet, ndërkohë në lejen e lëshuar në emër të të ndjerit, në pikën 4 të saj citohet se dëshmia është e vlefshme për 5 vjet.

41.3.6. Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, duke marrë në konsideratë faktin se kishim të bëjmë me pasoja të rënda, vdekjen e të ndjerit, jemi përpara gabimeve thelbësore dhe serioze që tregojnë mungesë të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, pasi: (i) nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuara më lart – në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë; (iii) vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të neni 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

42. Komisioni, pasi konstatoi problematikat e mësipërme në hetimin e veprës penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, i kërkoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Tropojë³⁶ të gjitha dosjet që janë hetuar nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë vepër penale.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë³⁷ informoi se subjekti ka trajtuar tri procedime, si vijon:

- nr. ***, trajtuar më lart;
- nr. ***³⁸ dhe nr. **/2020³⁹, për të cilat është vendosur mosfillimi – të dy këto procedime kishin të bënin me dëmtime individësh dhe jo punonjësish gjatë kryerjes së punës.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë⁴⁰ ka vënë në dispozicion dosjet e mëposhtme:

42.1. Procedimi penal nr. ***

42.1.1. Subjekti ka vendosur në datën 23.6.2009 pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “shkelje e rregullave të sigurimit teknik në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit të Procedurës Penale, duke konstatuar se nuk ka shkelje të rregullave të sigurimit teknik nga shtetasi F.H, por janë pakujdesia dhe shkeljet e bëra nga i dëmtuari N. M ato që kanë sjellë pasojën e plagosjes së rëndë të këtij shtetasi. Ky vendim është shfuqizuar nga prokurori i rrethit në datën 14.7.2009.

Subjekti, pasi ka administruar dëshminë e aftësisë së shtetasit F. H dhe aktekspertimin e kryer nga eksperti G.C, ka vendosur sërish pushimin e procedimit. Në vendim nuk janë parashtruar në mënyrë të qartë rrethanat konkrete të faktit, pasi subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar më tepër rëndësi citimit të deklarimeve të personave që kanë dijeni për veprën penale, duke anashkaluar paraqitjen e hollësishme dhe qartësisht të kuptueshme të rrethanave të faktit. Gjithashtu, vendimi mbështetet në rrethana fakti të verifikuara pjesërisht dhe në mungesë të kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore për të arritur në një konkluzion të drejtë mbi ekzistencën ose jo të elementëve të veprës penale.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 6.4.2021 dhe shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021

³⁷ Shkresë nr.*** prot., datë 15.4.2021

³⁸ Dëmtim aksidental i një individi gjatë kohës që po priste një pemë.

³⁹ Dëmtim aksidental i një individi gjatë kohës që po rregullonte derën e stallës.

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2021

Nga aktet e dosjes konstatohet se:

- i. akti i ekspertimit nuk ka bashkëlidhur dëshmitë e shtetasit G.C për të vërtetuar faktin që ka qenë ekspert i fushës për kryerjen e ekspertimit.
- ii. subjekti nuk ka administruar dokumentacionin e automjetit të drejtuar nga shtetasi F. H.
- iii. nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se shtetasi F.H nuk ka pasur lejen e drejtimit për drejtimin e automjetit me të cilin ka shkaktuar aksidentin⁴¹, si dhe nuk ka qenë i pajisur me dëshmi për drejtimin e këtij automjeti. Ky fakt konfirmohet dhe nga vetë z. F. H në deklaratimet e tij në datën 9.4.2009.
- iv. subjekti nuk i ka drejtuar shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Ministrisë së Transportit për të verifikuar nëse për drejtimin e mjetit ekskavator duhej dëshmi e aftësisë profesionale.
Bazuar në të dhënat e publikuar në faqen zyrtare të DPSHTRR-së⁴² rezulton se manovratorëve u jepet dëshmi aftësie për ekskavatoristë (për mjete me goma ose me zinxhirë).
- v. subjekti nuk ka administruar listëpagesat për periudhën 2006 – 2008 dhe periudhën janar – shkurt 2009 të shoqërisë “A. N” sh.p.k. për të vërtetuar deklaratimet e administratorit të kësaj shoqërie se z. F.H kishte 4 vjet⁴³ që punonte për këtë shoqëri.
- vi. subjekti, në arsyetimin e vendimit, parashtroi se z. F. H ka që prej vitit 2006 që punon në këtë shoqëri dhe ka bërë një kurs njëvjeçar për kryerjen e punimeve me ekskavator. Në aktet e dosjes nuk ka asnjë dokument për të vërtetuar kryerjen e kursit njëvjeçar nga ana e z. F.H, për më tepër kontrata e punës e lidhur midis shoqërisë “A.N” sh.p.k. dhe z. F. H është e datës 10.4.2007.
- vii. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me mundësinë e punësimit në mënyrë të paligjshme të të dëmtuarit N.M pranë shoqërisë “A.N” sh.p.k.
- viii. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të sqaruar rrethanat e ndodhjes së shtetasit N.M në ambientet ku ushtronte veprimtarinë shoqëria “A.N” sh.p.k. pa miratimin e kësaj shoqërie.
- ix. Duhej që të ishte realizuar kryerja e një akti riekspertimi teknik me grup ekspertësh, pasi akti i ekspertimit teknik, ku mbështetet vendimi i pushimit të çështjes, nuk përmban të gjitha elementet që duhet të ketë një akt i tillë në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj.
- x. Nga subjekti nuk rezulton të jetë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit.

Për arsyet e paraqitura më sipër, akti është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura. Konkluzionet e tij mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje. Në rrethanat e sipërpërmendura, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhet të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Subjekti i rivlerësimit nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë. Konkluzioni i prokurorit, në aspektin arsyetues, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf.

42.1.2. Në lidhje me këtë dosje, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektivit të rivlerësimit, si më poshtë vijon:

- i. Subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart. Në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e

⁴¹ Dëshmia e aftësisë për drejtim automjetesh e lëshuar në emër të z. F. H ka qenë për automjet për transport personash me mbi 8 vende.

⁴² <https://www.dpshttrr.al/shërbime/individe/dëshmi-dhe-certifikata>

⁴³ Sipas deklaratimeve të datës 19.5.2009, të z. E. Xh.

aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

- ii. Subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkëljes së rregullave të mbrojtjes në punë.

42.1.2.1. Për rrjedhojë, vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje.

42.1.3. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se në datën 23.6.2009 prej tij është vendosur pushimi i çështjes. Në datën 14.7.2009 vendimi është shfuqizuar nga drejtuesi i prokurorisë, ku është kërkuar aktekspertimi teknik, dokumentacioni i mjetit që është bërë shkak për incidentin dhe leja e drejtimit për shtetasin F. H. Nga ana e tij është caktuar ekspert ing. G. C, anëtar i shoqatës së ekspertëve dhe rikonstruksioneve dhe vlerësues i aksidenteve në Shqipëri. Është administruar leja e drejtimit (dëshmi aftësie) nr. *** për drejtim automjetesh të kategorive A, B, C dhe D, ku sipas saj personi që ka këtë dëshmi mund të drejtojë edhe automjetin me të cilën është kryer aksidenti. Nga deklaratimet e administratorit të firmës "A.N" sh.p.k., z. A.A, ndër të tjera, ka theksuar se për drejtimin e këtyre mjeteve (ekskavator me zinxhir e llojit "case") nuk ka leje të veçanta. Në deklaratimet e përgjegjësit të makinerive të kësaj firme shtetasi E.Xh, ndër të tjera, ka shpjeguar se: "F ka 4 vjet që punon si manovrator te firma jonë. F ka bërë 1 vit instruktazh për manovrator, nuk ka dëshmi aftësie për këto lloj mjetesh pasi nuk ka ndonjë kurs kualifikimi për këto lloj mjetesh". Këto thënie dhe deklaratime provohen sepse pasja e një dëshmie aftësie për drejtimin e mjetit në fjalë ka hyrë në fuqi me ligjin nr. **, datë 28.10.2011, "Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, Ce, D (*) dhe De, me certifikatën e aftësimin profesional (Cap)", pra, 2 vjet pas ngjarjes. Lidhur me gjetjen e pikës (i), që eksperti C nuk ka bashkëngjitur dëshmitë për të vërtetuar faktin që ai ka qenë ekspert i fushës, subjekti sqaron se ka qenë në listën e shoqatës së ekspertëve të cituar më lart.

Lidhur me gjetjen e pikës (ii), subjekti deklaron se dokumentacionin nuk është gjetur në mjet dhe nuk e ka pasur në administrim as drejtuesi i tij.

Lidhur me pikën (iv) ai sqaron se nuk e ka vlerësuar të domosdoshme, pasi ka menduar që për drejtimin e këtyre mjeteve nuk ka kurse kualifikimi, por është mjaftuar me deklaratimin e vetë drejtuesit, administratorit dhe përgjegjësit të makinerive.

Lidhur me gjetjen e pikës (v) për administrimin e listëpagesave për periudhat 2006 – 2008 dhe janar – shkurt 2009, nuk i ka kërkuar dhe nuk e ka parë të arsyeshme t'i kërkojë për administrim, pasi nuk ishte i dëmtuar punonjësi i firmës (drejtuesi i mjetit) F.H, por i dëmtuar është shtetasi N.M.

Lidhur me gjetjen e pikës (vi) është e vërtetë që shtetasi F. H është me kontratë pune 5-vjeçare për periudhën 10.4.2007 – 9 .4.2012 (përfshirë edhe periudhën kur ka ndodhur ngjarja), por kjo nuk do të thotë që nuk ka punuar apo nuk ka pasur kontratë para kësaj date dhe është mjaftuar me thëniet e personave të sipërcituar.

Lidhur me gjetjen e pikës (vii) nga ana e tij janë bërë verifikimet dhe ka rezultuar që ky shtetas nuk ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie bazuar në deklaratimet e tij dhe të shtetasve Gj.P, P.M, F.H, A.A, Dh.P dhe E.Xh. Lidhur me gjetjen e pikës (viii) është hetuar dhe është provuar nga të gjitha deklaratimet e marra në hetim që shtetasi N.M është afruar në afërsi të vendit të punës me dëshirën për të nxjerrë rrasa për përfitim monetar dhe pa marrë miratimin e firmës. Lidhur me gjetjen e pikës (ix) ai nuk e ka parë të arsyeshme të bëjë këtë veprim procedural, pasi akti i ekspertimit ka qenë i plotë dhe i saktë.

Lidhur me gjetjen e pikës (x) shoqëria "A.N" sh.p.k. me qendër në Kapshticë ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë "K" sh.p.k. datë 16.2.2009. Këto lloj kontratash nuk lidhen pa pasur dokumentacion të plotë të fushës dhe meqenëse i dëmtuar nga vepra penale nuk ka qenë punonjësi i shoqërisë, por një i jashtëm nuk e ka parë të arsyeshme të grumbullojë këtë dokumentacion.

42.1.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga analizimi i fashikullit penal konstatohen se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme. Ai nuk ka administruar dokumentacionin e mjetit për të verifikuar nëse ka qenë në gjendje të mirë teknike. Akteksptimi teknik, ku mbështetet vendimi i pushimit të çështjes, nuk përmban të gjitha elementet që duhet të ketë një akt i tillë në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj. Në akteksptim nuk pasqyrohet faktin nëse mjeti që po drejtonte shtetasi F. H ishte në gjendje të mirë teknike, si dhe nëse ky shtetas kishte kualifikimet e nevojshme për të drejtuar këtë mjet. Akteksptimi nuk ka bashkëlidhur dëshmitë e z. G. C për të vërtetuar që ai ka qenë ekspert i fushës dhe ka pasur dëshmi për të kryer këtë akt. Fakti që z. G.C ka qenë anëtar i shoqatës së ekspertëve dhe rikonstruksioneve nuk vërteton që ka pasur dëshmi për të kryer akteksptimin. Pavarësisht shpjegimeve të subjektit, në fashikullin penal nuk gjendet e administruar asnjë provë për të vërtetuar që z. F. H të ketë pasur dëshmi aftësie për këtë automjet, si dhe të ketë pasur kualifikimet e nevojshme për drejtimin e automjetit. Subjekti duhej t'i drejtohej Ministrisë së Transportit për të marrë një informacion të detajuar në lidhje me dëshminë apo kualifikimet e nevojshme për drejtimin e mjetit tip ekskavator, si dhe nëse dëshmia e aftësisë⁴⁴ për drejtim automjeti që kishte z. F.H ishte e mjaftueshme. Subjekti është bazuar vetëm në deklaratimet e dëshmitarëve në lidhje me punësimin e z. N.M, pa kryer asnjë veprim hetimor shtesë. Administrimi i listëpagesave mund të vërtetonte faktin nëse ky shtetas ka qenë i punësuar më parë në këtë shoqëri ose jo, por ky veprim nuk është bërë nga subjekti. Administrimi i listëpagesave do të vërtetonte edhe deklaratimet e përgjegjësit të makinerive të shoqërisë në lidhje me punësimin dhe kualifikimin e z. F. H në këtë shoqëri. Subjekti nuk ka administruar as dokumentacionin e shoqërisë për të vërtetuar faktin nëse kjo e fundit po i kryente punimet konform legjislacionit në fuqi dhe rregullave të caktuara në lejet e lëshuara për ushtrimin e aktivitetit të saj.

42.1.5. Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, duke marrë në konsideratë faktin se kishim të bënim dhe me një të plagosur rëndë, subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuara më lart, në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë; (iii) vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

42.2. Procedimi penal nr. */2019**

Subjekti ka vendosur në datën 4.4.2019 mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***/2019, pasi fakti nuk parashikohet në ligj si veprë penale ose fakti nuk ekziston.

42.2.1. Nga verifikimi i fashikullit penal rezulton se:

- i. subjekti nuk ka administruar aktin e ekspertimit mjeko-ligjor. Në dosje gjendet shkresa nr. ***/regj., datë 10.4.2019, e IML-së (pra pas vendimit të mosfillimit), ku i kërkohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë dërgimi i gjeneraliteteve të plota të shtetasit P.N;
- ii. subjekti nuk ka administruar akteksptimin teknik në lidhje me aksidentin e ndodhur;
- iii. nga aktet e dosjes nuk rezulton të jenë sqaruar detyrimet që ka punëdhënësi. Konkretisht: nuk është sqaruar nëse nga punëdhënësi janë marrë masat e nevojshme të sigurimit teknik

⁴⁴ Dëshmia e aftësisë për drejtim automjeteve të lëshuar në emër të z. H ka qenë për automjet për transport personash me mbi 8 vende.

- për shmangien e aksidenteve dhe ngjarjeve që cenojnë jetën dhe shëndetin e punonjësve; dhe nuk është sqaruar nëse i dëmtuari ka qenë i instruktuar;
- iv. subjekti nuk ka rezultuar të jetë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit;
- v. subjekti nuk ka administruar kontratën e punës së të dëmtuarit.

Për arsyet e paraqitura më sipër, akti është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura. Konkluzionet e tij mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje. Në rrethanat e sipërpërmendura, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhet të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Subjekti i rivlerësimit nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë.

42.2.2. Në lidhje me këtë dosje, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, si më poshtë vijon:

- i. subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuara më lart, në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhet të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes;
- ii. subjekti nuk ka analizuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë;

42.2.1. Për rrjedhojë, vendimi i mosfillimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje.

42.2.3. Pas kalimit të barrë së provës, subjekti ka sqaruar se *mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Komisariati i Policisë Lezhë në prokurori, në datën 20.3.2019, pasi studioi materialin dhe konstatoi se i dëmtuari ishte i siguarar te lista e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi me NIPT L****G për muajin shkurt të vitit 2019, konstatoi se në numrin rendor * ishte emri i tij, si dhe në deklaratën e datës 15.3.2019, të lëshuar nga i dëmtuari, ku thuhet se për datën 14.3.2019 (ditë feste zyrtare) një pjesë e punëtorëve, duke përfshirë edhe atë, ra dakord që të punonin dhe i thanë pronarit të shkonin në punë sepse kishin interes pasi dita e punës ishte 50% më e lartë [...] nga ora 9 kur po pastronte gaterrin, rrëshqiti dhe ra me shpinë...*

Subjekti ka pretenduar se priti ardhjen e përgjigjes së aktekspertimit, e cila nuk i erdhi brenda 14-ditëve dhe meqenëse afati për regjistrimin e procedimit penal është 15 ditë, në datën 4.4.2019 ai vendosi mosfillimin e procedimit penal, që fakti nuk parashikohet në ligj si vepër penale dhe e dërgoi dosjen për qepje dhe arshivim. Në momentin që iu kërkua sqarim shkoi në prokurori dhe e kërkoi këtë material, ku konstatoi se në dosjen e këtij mosfillimi ndodhej një shkresë e IML-së Tiranë, që mbante datën 10.4.2019, e cila kërkonte saktësimin e gjeneraliteteve të shtetasit P.N, pasi me këtë emër dhe mbiemër janë dy persona. Gjithashtu, në datën 16.4.2019 kishte ardhur edhe një dëshmi mjeko-ligjore me nr. ** e ekspertit mjeko-ligjor Lezhë, i cili thoshte se nuk mund ta bëjë këtë aktekspertim, pasi i dëmtuari ka shkuar në Tiranë dhe duhet ta kërkonin atje. Me të dy këto shkresa nuk është njohur.

42.2.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti nuk mund të vendoste mosfillimin e procedimit pa administruar aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, si dhe kryerjen e një ekspertimi teknik në lidhje me aksidentin e ndodhur. Nga aktet e dosjes nuk rezulton të jenë sqaruar detyrimet që ka punëdhënësi. Konkretisht: (i) nuk është sqaruar nëse nga punëdhënësi janë marrë masat e nevojshme të sigurimit teknik për shmangien e aksidenteve dhe ngjarjeve që cenojnë jetën dhe shëndetin e punonjësve; (ii) nuk është sqaruar nëse i dëmtuari ka qenë i instruktuar. Nga

subjekti nuk rezulton të jetë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit.

Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, duke marrë në konsideratë edhe faktin që kishim të bënim me një të plagosur rëndë, por në mungesë të një aktekspertimi mjeko-ligjor për të përcaktuar shkallën e dëmtimit, subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuarra më lart, në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë; (iii) vendimi i mosfillimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

42.3. Procedimi penal nr. */2014**

Në datën 10.11.2014 subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***/2014, për veprën penale “shkelje të rregullave të sigurimit teknik në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit të Procedurës Penale, me motivacionin se ishte para një rasti fatkeq, pasi nuk ka shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë nga punonjësit e firmës ndërtuese të HEC-it.

42.3.1. Nga verifikimi i fashikullit penal ka rezultuar se:

- i. duhej që të ishte realizuar kryerja e një akti riekspertimi teknik me grup ekspertësh, pasi ky akt ku mbështetet vendimi i pushimit të çështjes, nuk përmban të gjithë elementët që duhet të ketë një akt i tillë në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj;
- ii. subjekti nuk ka administruar në dosje policën e sigurimit nga aksidentet personale të punonjësve;
- iii. subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit;
- iv. subjekti nuk ka administruar projektin e miratuar nga Ministria e Ekonomisë për ndërtimin e HEC-it F
- v. në dosje është administruar dokumentacion në gjuhë të huaj i papërkthyer dhe pa vulë apostile;
- vi. subjekti nuk u është drejtuar organeve tatimore për të vërtetuar faktin e deklaramit të viktimave në organet tatimore;
- vii. subjekti nuk ka administruar lejet e posaçme të viktimave për detyrën e zjarrmëtarit;
- viii. subjekti nuk ka administruar kontratat e punës të viktimave me shoqërinë;
- ix. në dosje nuk ndodhet urdhri i punës i datës së ndodhjes së aksidentit.

43.2.1.1. Për arsyet e paraqitura më sipër, akti është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura. Konkluzionet e tij mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje. Në rrethanat e sipërpërmendura, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhet të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Subjekti i rivlerësimit nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë. Konkluzioni i prokurorit, në aspektin arsyetues, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf.

42.3.2. Në lidhje me këtë dosje, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, si më poshtë vijon:

- i. subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart, në këto rrethana kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes;
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë.

42.3.2.1. Për rrjedhojë, vendimi i mosfillimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje.

42.3.3. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se *lidhur me gjetjen e pikës (i), akti i parë është bërë nga ekspertët shtetërorë pranë repartit të inspektim-shpëtimit të minierave që është pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë Tiranë.*

*Lidhur me gjetjen e pikës (ii) ai ka administruar në dosje listëpagesat e të gjithë punëtorëve e përbërë nga 3 fletë, ku në numër rendor 60 rezulton i ndjeri P. D, me nr. ID F***S me profesion zjarrmëtar; me numër rendor *** rezulton i ndjeri N.L, me nr. ID G*** K, me profesion zjarrmëtar; me numër rendor *** rezulton i ndjeri H.A, me nr. ID U***, me profesion zjarrmëtar, që vërteton që janë derdhur të gjitha kontributet.*

*Lidhur me gjetjen e pikës (iii) me administrimin e lejes, licenca dhe autorizimet e nevojshme janë quajtur se ekzistojnë, pasi Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. ***, datë 30.5.2012, i është drejtuar shoqërisë koncensionare “A.A. E” sh.p.k., e cila citon se është miratuar projekti i zbatimit të disa hidrocentraleve, ndërmjet tyre edhe ai i F.*

Lidhur me gjetjen e pikës (iv) ai e ka konsideruar të panevojshëm administrimin e këtij projekti, pasi është mjaftuar me shkresën e Ministrisë së Drejtësisë, ku citohet “Miratohet projekti i zbatimit të hidrocentraleve”.

Lidhur me gjetjen e pikës (v) për administrimin e dokumenteve në gjuhë të huaj dhe pa vulë apostile, sqaron se ky dokument është marrë nga OPGJ-ja me procesverbal këqyrje-marrje dokumenti dhe nuk e ka vlerësuar se duhej përkthyer.

Lidhur me gjetjen e pikës (vi) në lidhje me shkresën që i duhej t’i dërgohej Drejtorisë së Tatim-Taksave, sqaron se ajo është marrë me procesverbal këqyrje-marrje, ku konstatohen prania e të ndjerëve në këto listëpagesa të detyrimeve dhe kontributeve.

Lidhur me gjetjen e pikës (vii), sqaron se në dosje janë të administruara lejet për ushtrimin e profesionit të zjarrmëtarit për të tre të ndjerët, në faqet 554, 555 dhe 556 të dosjes hetimore. Në dosje ndodhet edhe lista e zjarrmëtarëve të instruktuar në datën 15.7.2014, ku janë emrat e të ndjerëve në numrat e regjistrimit datë 5.13.17, ku edhe kanë nënshkruar në këtë listë. Subjekti deklaron se duhet të merret në konsideratë që ky procedim ende nuk ka përfunduar.

42.3.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me lejet e posaçme të viktimave konstatohet se ato janë pjesë e fashikullit penal, por nuk janë administruar gjatë kohës që veprimet hetimore po kryheshin nga subjekti i rivlerësimit. Lejet e zjarrmëtarit janë administruar nga prokurori tjetër që ka vijuar hetimet, i cili ka vendosur pezullimin e procedimit deri në ardhjen e letërporosisë nga Turqia. Në lidhje me pretendimin e subjektit që ky procedim nuk ka përfunduar, Komisioni, bazuar edhe në vendimin nr. **, datë 23.10.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁴⁵, vlerëson se për sa kohë nga subjekti është vendosur pushimi i çështjes, pra ka një vendim përfundimtar

⁴⁵ Në pikën 14.7 të vendimit, Kolegji shprehet: “Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: [...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë. Në këto rrethana, çështja gjyqësore e analizuar ka përfunduar shqyrtimin e saj prej subjektit të rivlerësimit, i cili është shprehur me vendimin përfundimtar për zgjidhjen e saj dhe qenia e saj e varur para Gjykatës së Lartë, në pritje të një gjykimi atje, nuk e bën këtë çështje “nën shqyrtim”, në kuptim të parashikimit të nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, për pasojë, Komisioni ka qenë i legjitimuar të analizojë e vlerësojë edhe këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit”.

nga ana e tij, Komisioni legjitimohet të analizojë këtë vendim dhe të ngarkojë me përgjegjësi subjektin për mungesën e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore. Fakti që ky procedim aktualisht ka statusin “pezulluar” nuk lidhet me vendimmarrje të subjektit, por me vendimmarrje të subjekteve të tjerë. Vendimi i pushimit të subjektit është shfuqizuar në datën 15.12.2014 nga drejtuesi i prokurorisë, pasi aktekspertimi i administruar nga subjekti është shprehur në mënyrë jo të plotë dhe të qartë për të përcaktuar se cili ka qenë shkaku i ndodhjes së këtij aksidenti. Ky procedim më pas i ka kaluar një prokurori tjetër.

42.3.4.1. Komisioni vlerëson gjithashtu se subjekti, duke marrë në konsideratë edhe faktin që kishim të bënim me tre viktime, si dhe bazuar në dinamikën e ngjarjes, duhej të kishte kërkuar kryerjen e një akti riekspertimi teknik me grup ekspertësh, pasi aktekspertimi teknik, ku mbështetet vendimi i pushimit të çështjes, nuk përmban të gjithë elementët që duhet të ketë një akt i tillë në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj. Nga ana e tij nuk është administruar në dosje polica e sigurimit nga aksidentet personale të punonjësve, si dhe i gjithë dokumentacioni i shoqërisë për të vërtetuar nëse kjo e fundit po kryente veprimtari konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Fakti se kjo shoqëri kishte lidhur një kontratë koncesionare nuk e përjashton nga detyrimi për t’u pajisur me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për të ushtruar veprimtarinë konform legjislacionit në fuqi. Në dosje nuk ndodhet dhe urdhri i punës i datës së ndodhjes së aksidentit.

42.3.4.2. Komisioni çmon se duke marrë në konsideratë edhe faktin se tre punonjës kishin humbur jetën, subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart, në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) subjekti nuk analizon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme elementët e veprës penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë; (iii) vendimi i mosfillimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

43. Në përfundim të hetimit administrativ për kriterin e aftësive profesionale, Komisioni ka konstatuar se aktiviteti profesional i subjektit të rivlerësimit në lidhje me hetimin e procedimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal është i shoqëruar me njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime ose një model pune aq të dobët, sa që ka rrezikuar apo cenuar të drejtat e qytetarëve, duke i kaluar barrën e provës subjektit. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës.

43.1. Subjekti nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me këtë rezultat hetimi, por deklaroi se nuk ka cenuar të drejtat e palëve, pasi si palët, ashtu edhe viktimat, i kanë fituar të drejtat dhe nuk ka pasur ankime kundër vendimeve të tij në gjykatë.

43.2. Komisioni, në lidhje me hetimin e procedimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, të kryera nga subjekti, vlerëson se është vendosur mosfillimi i procedimit penal ose pushimi i tij, pa hetim ose pa kryer hetime të plota. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit që ka hetuar këto dosje, në disa raste ka interpretuar gabim ligjin dhe gjithashtu vendimet e marra prej tij nuk janë arsytuar plotësisht, sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale. Duke pasur parasysh legjislacionin e brendshëm dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, hetimi i rasteve që kanë të bëjnë me humbjen e jetës ose dëmtimin e rëndë të punonjësit nuk është i plotë, pasi nuk rezultojnë përpjekje serioze nga prokurori për të zbuluar se çfarë ka ndodhur. Në fakt konstatohet se është mbërritur në përfundime të nxituara, të bazuara në akte të cekëta ekspertize teknike, që nuk mbështeten në prova për të mos filluar ose mbyllur hetimet dhe që kanë shërbyer si bazë e vendimeve të tij të arsytuara në kundërshtim

me ligjin. Kjo tregon mungesën e kapacitetit/aftësisë së prokurorit në aspektin e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor.⁴⁶ Rezulton se, në vend që të respektoheshin parimet dhe vlerat/standardet më të larta të prokurorisë,⁴⁷ të cilat përfshijnë detyrimin për të ndërmarrë veprime dhe për të pasur një rol aktiv në zbulimin e së vërtetës dhe detyrimin për të respektuar, mbrojtur dhe mbështetur dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut, është shfaqur neglizhencë e vazhdueshme në një seri të qartë dhe të vazhdueshme vendimesh. Gjithashtu, Komisioni, vlerëson se një shpërfillje e tillë dhe neglizhim ndaj humbjes së jetëve njerëzore, nuk përputhet me rolin e prokurorit.

43.2.1. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit përbën një model pune aq të dobët, saqë rrezikon ose shkel të drejtat e qytetarëve. Me këtë model pune prokurori dështon së kryeri detyrën e tij për të respektuar, mbrojtur dhe mbështetur dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut. Prandaj, nisur nga konkluzionet e nxjerra nga analizimi i dosjeve të mësipërme, Komisioni çmon se pozita e subjektit duhet të konsiderohet në vështrim të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili citon: “...5. Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”

44. Të dhëna nga burime arkivore

44.1. Nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore, sektorit të protokoll - arkivit, etj., në Prokurorinë e Përgjithshme dhe informacionet/përgjigjet e ardhura nga të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk janë dhënë masa disiplinore për shkelje disiplinore të kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit.

44.2. Në sektorin e protokoll - arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme janë identifikuar të administruara 2 ankesa ndaj subjektit, të paraqitura nga shtetas të ndryshëm.

44.3. Pranë protokoll - arkivit të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme ka të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar, si dhe urdhrin nr. ***, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”.

Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme gjenden 3 vlerësime të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin Agim Dalipaj, të cilat i përkasin punës së tij për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, si vijon:

- për vitin 2014 është vlerësuar “mirë”;
- për vitin 2015 është vlerësuar “shumë mirë”;
- për vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”.

45. Denoncimet

Komisioni ka administruar 14 denoncime (5 prej të cilave nga dy denoncues) nga publiku për subjektin Agim Dalipaj. Subjektit iu kalua barra e provës për disa prej tyre:

45.1. Denoncimet e shtetasit L. P⁴⁸

⁴⁶ Referohu pikës 3 të nenit 73, “Aftësitë profesionale të prokurorit”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁴⁷ Referohu nenit 75, “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁴⁸ Denoncimet nr. *** prot., datë 14.6.2019, dhe nr. *** prot., datë 19.6.2019.

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore.

45.1.1. Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga denoncuesi rezulton se:

- i. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin⁴⁹ nr. ***, datë 23.3.2018, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës për pushim dhe kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, që i përkasin procedimit penal nr. ***/2017”.
Në vendimin e saj gjykata ka konstatuar mangësi në hetim, duke kthyer aktet dhe i ka caktuar subjektit një afat 60-ditor për kryerjen e hetimeve.
- ii. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendim nr. **, datë 4.2.2019, ka vendosur sërish “Rrëzimin e kërkesës për pushim dhe kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, që i përkasin procedimit penal nr. ***/2017”.
Në vendimin e saj gjykata ka konstatuar subjekti nuk i ka kryer të gjitha veprimet hetimore të cituar në vendimin nr. ***, vendim që nuk është zbatuar nga prokuroria, duke sjellë si pasojë që të përsëritet një kërkesë e pabazuar në ligj për pushimin e çështjes.

45.1.2. Komisioni, duke analizuar vendimet e gjykatës të vënë në dispozicion nga ankuesi, i ka kaluar subjektit barrën e provës, si vijon:

45.1.2.1. Kërkesa për pushimin e procedimit penal nr. ***/2017 nuk është rezultat i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, pasi subjekti:

- i. nuk ka argumentuar hollësisht përse fakti nuk përbën vepër penale, por është çështje civile;
- ii. shprehet se fakti që ka rezultuar gjatë hetimeve nuk përbën vepër penale pa analizuar në përputhje me provat e administruara dhe hetimet që janë kryer deri në ato momente.
- iii. nuk ka bërë asnjë lloj hetimi apo verifikimi për shpalljen e pavlefshme nga Gjykata e Lartë të kontratës së shitjes nr. ****, datë 9.11.2010;
- iv. nuk ka kryer një hetim të plotë në lidhje me mënyrën e përfitimit të pronësisë nga shtetasi Gj. N mbi pasurinë e paluajtshme nr. *** dhe ekzistencën e kontratës së shitjes nr. ****, datë 9.11.2010, lidhur midis tij dhe Bashkisë Lezhë;
- v. është bazuar në deklarinimin e personave pa administruar të gjithë dosjen e Bashkisë Lezhë që ka vendosur miratimin e lejes së ndërtimit për shtetasin Gj. N dhe dosjen pranë ZVRPP-së Lezhë, si dhe nuk ka marrë informacion në lidhje me mënyrën e përfitimi të pasurisë nr. *** nga shtetasi Gj.N;
- vi. nuk ka kërkuar kryerjen e një ekspertimi topografik për të përcaktuar nëse ndërtimi po kryhet apo jo në përputhje me lejen zhvillimore të ndërtimit nr. *** prot., datë 5.8.2015;
- vii. nuk ka administruar dosjen gjyqësore civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në lidhje me vendimin nr. ***, datë 20.10.2017.

45.1.2.2. Subjekti nuk ka zbatuar afatet e përcaktuara nga gjykata në vendimin nr. ***, datë 23.3.2018, duke zvarritur procedimin penal përtej afatit 60-ditor të caktuar nga gjykata, si dhe nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të kërkuara nga gjykata, duke vepruar në kundërshtim me nenin 329/3, germa b⁵⁰ e Kodit të Procedurës Penale.

45.1.3. Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka sqaruar se *Gjykata e Lezhës, për vendimin nr. **, datë 23.3.2018, ka rrëzuar kërkesën për pushim dhe ka kthyer aktet plotësisht hetimesh, duke lënë edhe detyra që të kryhen brenda 60 ditëve [...]. Gjykata e apelit, me vendimin nr. **, datë 26.7.2018, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë [...]. Pas plotësimit të detyrave të lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë kanë dërguar përsëri kërkesën për pushimin e hetimeve në datën 24.11.2018, e cila përsëri është rrëzuar me vendimin nr. **, datë 4.2.2019, me afat 30-ditor dhe janë lënë detyra...*

⁴⁹ Lënë në fuqi me vendim nr. ***, datë 26.7.2018, nga Gjykata e Apelit Shkodër.

⁵⁰ Kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtëtimet e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë.

45.1.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Bazuar në provat e depozituara nga subjekti procedimi i ka kaluar sërish këtij të fundit në datën 24.10.2018 dhe kërkesa për pushim është depozituar prej tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë në datën 13.12.2018, pra, brenda fatit 60-ditor të përcaktuar nga gjykata. Por, pavarësisht këtij fakti, nga subjekti nuk rezulton të jenë zbatuar detyrimet e përcaktuara nga gjykata, të cilat kanë sjellë si pasojë edhe kthimin e akteve.

Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale subjekti ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohen: (i) mangësi në drejtim të hetimit të plotë të çështjes dhe hetim i dobët nga subjekti; (ii) subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të kërkuara nga gjykata, duke vepruar në kundërshtim me nenin 329/3, germa “b”⁵¹ e Kodit të Procedurës Penale, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

45.2. Denoncimi i shtetases V. M⁵²

Denoncuesja ankohet për zvarritje të procedimit dhe moszbatim të vendimeve të gjykatave, të cilat e kanë vendosur disa herë kthimin e vendimit të pushimit për të vijuar me hetimet.

45.2.1. Komisioni, duke analizuar vendimin e pushimit datë 27.4.2018, të subjektit të vënë në dispozicion nga ankuesi, konstaton se subjekti e ka zvarritur procedimin penal nr. ***/2009 për një periudhë 10-vjeçare, zvarritje e cila rezulton se ka ardhur për shkak të:

- i. moszbatimit të detyrave të lëna nga gjykata në 4 vendime⁵³ të njëpasnjëshme për kthimin e çështjes dhe vazhdimin e hetimeve; si dhe
- ii. moskryerjes brenda një afati të arsyeshëm të veprimeve hetimore, të cilat në rifillimin e fundit të hetimeve kanë zgjatur për një periudhë njëvjeçare.

45.2.2. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se *ky procedim penal ka filluar në vitin 2009, i cili nuk është hetuar prej tij por nga prokurorë të tjerë dhe këtë çështje e ka marrë në vitin 2018 dhe ka vazhduar hetimin e dërguar kërkesën për pushim...*

45.2.3. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, konstaton se provohet që subjekti nuk e ka zvarritur këtë çështje për 10 vjet, pasi ai është caktuar për hetimin e saj në datën 8.2.2018.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

46. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, dosjeve të administruara nga Komisioni dhe denoncimeve të depozituara, trupi gjykues konstaton gabime thelbësore dhe serioze, si dhe ekzistencën e një serie të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjektit. Ai ka treguar cilësi të papranueshme në punë dhe gjykim të dobët, që çojnë në cenim të të drejtave të palëve. Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

47. Të gjitha këto të meta të konstatuara në vlerësimin profesional të subjektit vlerësohet se cenojnë besimin e publikut tek një magjistrat.

48. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, në atë shkallë sa programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit.

49. Në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë dhe atë profesional për subjektin e rivlerësimit, në kuptim

⁵¹ Kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtimet e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë.

⁵² Denoncim nr. ***, datë 25.5.2018

⁵³ Procedimi penal është pushuar 4 herë dhe në të katërta herët vendimi i pushimit është kthyer nga gjykata për vijimin e hetimeve.

të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku e të para në harmoni me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i atij sistemi.

Në këto rrethana, përfshihen problematika e konstatuar në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë në lidhje me situatën e konfliktit të interesit, si dhe sjellja e subjektit në drejtim të trajtimit të çështjeve penale që lidhen me hetimin e veprave penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë, të cilat kanë sjellë si pasojë humbjen e jetës së qytetarëve ose dëmtimin e rëndë të tyre.

Mënyra e veprimit të subjektit, si për përfitimin e pasurisë në kushtet e konfliktit të interesit, ashtu edhe paaftësia në kryerjen e procedurave hetimore, do të lexohej nga publiku si një sjellje që nuk ngjall besim te sistemi i drejtësisë.

Në vlerësimin e Komisionit, këto rrethana të sipërcituara do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash mbi të cilën mund të konkludohej se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që kanë bërë të mundur aplikimin e pikave 3 dhe 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

50. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve, konkludon se:

- i.** subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji;
- ii.** subjekti rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale;
- iii.** nga vlerësimi tërësor, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Branko Hrvatin, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Agim Dalipaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 17.6.2021

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Alma FASKAJ
Anëtare

Genta Tafa (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha